

1 E martë, 20 shkurt 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
4 videolidhjes]

5 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

6 --- Seanca fillon në orën 09.03

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Dhoma e Specializuar
11 kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup
12 Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
14 Mirëdita, të gjithëve. Vërej se z. Krasniqi sot paraqitet
15 përmes videolidhjes dhe të akuzuarit e tjerë janë të pranishëm
16 në sallë. Gjithashtu, vërej se Gjykatësi Barthe merr pjesë
17 përmes videolidhjes këtë javë.

18 Në fillim janë dy çështje paraprake të cilat kërkojnë
19 vëmendje.

20 Duke pasur parasysh ndryshimin e avokatëve dhe
21 kohëzgjatjen e këtij procesi, dëshiroj që t'ju rikujtoj të
22 gjitha palëve për disa detyrime që lindin nga Udhëzuesi i
23 Punës për Mbrojtësit dhe Kodin e Sjelljes Profesionale për
24 Mbrojtësit para kësaj Gjykate.

25 Në bazë të neneve 22(4) dhe 24(1) (a) dhe (b) të Kodit të

1 Sjelljes, mbrojtësit duhet të kryejnë në çdo moment detyrën e
2 përfaqësimit në mënyrë efikase dhe interesit më të mirë të
3 klientit. Në kryerjen e këtyre përgjegjësive, mbrojtësit duhet
4 që ta përfaqësojnë klientin në mënyrë efikase dhe efektive me
5 qëllim shmangien e shpenzimeve të panevojshme dhe/apo vonimin
6 e procesit dhe të veprojnë për të mbrojtur interesin më të
7 mirë të klientit.

8 Këto përgjegjësi përfshijnë domosdoshmërisht edhe
9 detyrimin e mbrojtësit për të siguruar që ata të kenë
10 bashkëmbrojtës kompetent dhe të disponueshëm në mënyrë që të
11 paraqiten pa vonesë në këtë proces në emër të tyre në situatat
12 kur mbrojtësit nuk kanë mundësi që të paraqiten vetë.

13 Gjithashtu, ju kujtoj se sipas seksionit 6(2)(a) dhe (d)
14 të Udhëzuesit të Punës për Mbrojtësit, aplikuesit për t'u
15 pranuar në listën e mbrojtësve duhet që të paraqesin një
16 deklaratë lidhur me disponueshmërinë dhe një deklaratë për të
17 respektuar Kodin e Sjelljes Profesionale. Prandaj jo vetëm
18 bashkëmbrojtësit duhet që të informojnë Zyrën Administrative
19 për gatishmërinë e tyre për t'u paraqitur në një çështje
20 gjyqësore, por duhet që ta mbajnë të informuar administratorin
21 për çdo ndryshim të disponibilitetit të tyre. Në mungesë të
22 një njoftimi të tillë, kjo interpretohet se bashkëmbrojtësi
23 është i gatshëm për t'u paraqitur.

24 Në fund, ju rikujtoj se sipas sesionit 18(4) të
25 Udhëzuesit të Punës thuhet se:

1 "Bashkëmbrojtësi i përzgjedhur duhet të ketë autoritetin
2 për nënshkruar dokumente dhe të paraqitet në sallën e gjyqit
3 në emër të Mbrojtësit, për t'u marrë me të gjitha çështjet
4 përkatëse".

5 Në përputhej me sa më lart, Trupi Gjykues lëshon një
6 urdhër gojarisht.

7 Trupi Gjykues udhëzon administratorin që të dorëzojë një
8 akt-procesverbal lidhur me detyrimet e mbrojtësve brenda datës
9 26 shkurt 2024 dhe të kërkoj nga z. Misetiç të bëjë të ditur
10 nëse ai do të vendosë që të mbajë si bashkëmbrojtës ndonjë apo
11 të gjithë bashkëmbrojtësit që janë aktualisht të renditur në
12 ekipin e z. Thaçi apo do të kërkojë caktimin si bashkëmbrojtës
13 të ndonjë personi tjetër.

14 Trupi Gjykues udhëzon z. Misetiç që të informojë, pa
15 vonesë, çdo individ të cilin ai kërkon që të mbajë apo kërkon
16 që të caktohet si bashkëmbrojtës që të përgatiten për të
17 përfaqësuar z. Thaçi në Dhomat e Specializuara, nëse do të
18 thirren nga z. Misetiç apo nëse ua kërkon Trupi Gjykues.

19 Të informojë administratorin brenda 4 marsit 2024 për çdo
20 person aktualisht të renditur në listën e bashkëmbrojtësve të
21 renditur në listën e bashkëmbrojtësve të Ekipit të Mbrojtjes
22 së z. Thaçi të cilët nuk janë të përgatitur që të vijojnë të
23 jenë të tillë në mënyrë që administratorja t'i heq këta
24 persona nga lista e bashkëmbrojtësve. Z. Misetiç mund t'i
25 kërkojë administraziores që të mbajë disa ose të gjithë këta

1 individë në listën e Ekipit të Mbrojtjes së z. Thaçi në
2 cilësinë e tyre që ai e mendon të domosdoshme.

3 Dhe t'i japë Administratores një listë të përditësuar të
4 anëtarëve të Ekipit të Mbrojtjes së z. Thaçi brenda 11 marsit
5 2024, pra, në datë 11 mars 2024.

6 Trupi Gjykues thekson sesa më lart zbatohet për të gjithë
7 mbrojtësit në të gjitha ekipet e tyre.

8 Këtu mbyllet ky urdhër gojarisht.

9 Sa i takon çështjes së dytë paraprake.

10 Trupi Gjykues këshillon palët që ato do të marrin një
11 kalendar të seancave për pjesën e mbetur të këtij viti në
12 shtator deri në dhjetor 2024, përpara mbylljes së seancës sot,
13 sot mbas dreke. Trupi Gjykues, gjithashtu, do të marrë një
14 listë të pikave të diskutimit për përcaktimin e kalendarit dhe
15 çështjet që do të diskutohen dhe nesër.

16 Tani fillojmë me Dëshmitarin e Prokurorisë.

17 Po.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Sa i takon kundrapyetjeve, unë do
19 bëj i pari kundërpyetjet, pastaj z. Misetiç.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
21 E kishim shënuar, po faleminderit që na e rikujtuat.

22 Jemi në seancë publike.

23 Znj. Sekretare, ju lutem shoqëroni dëshmitarin të hyjë në
24 sallë.

25 Z. BAARLINK: [Përkthim] Sa të vijë dëshmitari, kemi

1 qarkulluar një material për ta ndihmuar dëshmitarin sa u takon
2 masave mbrojtëse, do shkoj t'ia japim një kopje të këtij
3 dokumenti.

4 Shpresoj që të mos ketë kundërshtime lidhur me këtë fletë
5 informuese për masat mbrojtëse.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

7 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,
9 Dëshmitar.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëdita.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistentja e
12 Sallës do t'ju japë tekstin e deklaratës solemne të cilën ju
13 kërkohet që ta lexoni në bazë të rregullës. Mund ta shihni dhe
14 ta lexoni me zë.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
16 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
17 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
18 vetëm të vërtetës dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të
19 cilën kam dijeni.

20 DËSHMITARI: W00498

21 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
23 Dëshmitar. Mund të uleni.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,

1 sot do të fillojmë me dëshminë tuaj, e cila pritet që të
2 zgjasë katër orë e gjysëm. Siç mund ta dini, në fillim pyetjet
3 do t'jua bëjë Prokuroria. Pasi të mbarojnë ata, Ekipet e
4 Mbrojtjes mund t'ju bëjnë pyetje edhe anëtarët e Trupit
5 Gjykues mund t'ju bëjnë pyetje.

6 Prokuroria mendon se ka nevojë për 30 minuta që t'ju bëjë
7 pyetje. Ekipet e Mbrojtjes mendojnë se kanë nevojë 4 orë. Ne i
8 nxisim të gjithë Avokatët që të përdorin në mënyrë efikase
9 kohën. Trupi Gjykues mund të lejojë edhe pyetje plotësuese
10 nëse plotësojnë kushtet.

11 Z. Dëshmitar, pyetjeve t'ju përgjigjeni qartë, me
12 përgjigje të shkurtra, me fjali të shkurtra. Nëse nuk e
13 kuptoni pyetjen, lirisht mund t'i kërkonit personit që ua bën
14 pyetjen t'ua përsëritë atë ose tua sqarojë.

15 Ju lutem, jepni përgjigje vetëm në bazë të asaj që juve
16 keni dijeni sa i takon fakteve dhe rrethanave për të cilat ju
17 bëjnë pyetje.

18 Nëse Prokuroria ju kërkon që të bëni disa korrigjime në
19 deklaratën e mëparshme, ju rikujtojmë se duhet që ato
20 deklaratat të pasqyrojnë sa më qartë atë çfarë keni për të
21 thënë.

22 Ju lutem flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë minuta
23 përpara se t'ju përgjigjeni pyetjeve dhe flisni ngadalë në
24 mënyrë që t'ju përkthejnë përkthyesit.

25 Ndërkohë që jepni dëshmi këtu në sallë, nuk ju lejohet që

1 të diskutoni për përmbajtjen e dëshmisë suaj jashtë kësaj
2 salle gjyqi me askënd gjersa të keni mbaruar dhënien e
3 dëshmisë suaj. Nëse dikush ju bën pyetje jashtë sallës lidhur
4 me dëshminë tuaj, ju lutem na e bëni të ditur këtë.

5 Nëse unë do t'ju kërkoj që mos flisni më, ju lutem mos
6 flisni më, po kështu këtë mund t'jua kërkoj edhe duke ngritur
7 dorën. Kjo do të thotë se kam nevojë që t'ju jap një udhëzim.

8 Nëse keni nevojë që të bëni pushim, na e thoni dhe mund
9 t'jua plotësojmë këtë nevojë.

10 Në orën 10.00 do të bëjmë një pushim prej dhjetë
11 minutash.

12 Dëshmitar, do të fillojmë me pyetjet që do t'jua bëjë
13 Zyra e Prokurorit të Specializuar, i cili është ulur në të
14 majtën tuaj.

15 Z. Prokuror, mund të filloni.

16 Z. BAARLINK: [Përkthim] Faleminderit.

17 Pyetje nga Z. Baarlink:

18 Z. BAARLINK: [Përkthim]

19 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Jemi takuar më përpara, por
20 procesverbal, do prezantohem sërish. Më quajnë Nico Baarlink
21 dhe do të bëj pyetje sot në emër të ZPS-së.

22 Z. BAARLINK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju lutem të
23 kalojmë në seancë private për të marrë hollësitë identifikuese
24 të dëshmitarit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

1 Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7 [Seancë e hapur]

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

9 jemi tani në seancë të hapur.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

11 Mund të vazhdoni.

12 Z. BAARLINK: [Përkthim

13 PY. Z. Dëshmitar, ju rikujtoj se jemi në seancë të hapur,

14 pra, publiku mund të dëgjojë atë që thoni ju dhe ne.

15 Z. Dëshmitar, më përpara ju ka marrë në pyetje Task Forca

16 Hetimore Speciale?

17 PË. Kush, më falni?

18 PY. Task Forca e Posaçme Hetimore që ishte organizata që

19 pastaj u bë ZPS-ja.

20 PË. Po.

21 Z. BAARLINK: [Përkthim] Ju lutem Sekretares që të nxjerrë

22 dokumentin 00152-TR RED, nuk është për t'u parë nga publiku.

23 PY. Dëshmitar, e shihni dokumentin përpara jush?

24 PË. Po, e shoh.

25 PY. A e njihni që kjo është intervista që keni dhënë?

1 PË. Po.

2 PY. Kohët e fundit, domethënë, kur erdhët këtu herën e
3 fundit, a ju dha mundësia që të familjarizoheni me përmbajtjen
4 e kësaj interviste?

5 PË. Po.

6 PY. Gjatë seancës përgatitore, kur ishit këtu në muajin
7 dhjetor, bëtë të ditur se nuk kishit asnjë korrigjim për t'i
8 bërë kësaj interviste. Megjithatë bëtë disa sqarime në
9 përgjigje të pyetjeve, kështu është?

10 PË. Kështu është.

11 PY. Dhe këto sqarime janë pasqyruar në shënim zyrtar të cilat
12 pastaj ju janë lexuar?

13 PË. Po, janë përfshirë edhe në shënime.

14 PY. A konfirmoni se ajo që ju ishte lexuar, që ishte
15 përfshirë në shënime, i pasqyrojnë plotësisht dhe saktë
16 sqarimet tuaja?

17 PË. Po, e konfirmoj. Kështu është.

18 PY. Faleminderit. Dhe në varësi të sqarimeve, duke pasur
19 parasysh edhe sqarimet në atë shënim, intervista, transkripti
20 i intervistës që është në ekran pasqyron saktë atë që keni
21 thënë aso kohe dhe që do të thoshit sot këtu po t'ju bëheshin
22 pyetje sallë?

23 PË. Po, kështu është, e gjitha e saktë është.

24 PY. Faleminderit.

25 Z. BAARLINK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W00498 (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Baarlink

Faqe 12

1 përmbushje të kriterëve të rregullës 154 në përputhje me
2 vendimin 1976, ZPS-ja i kërkon që të gjitha pjesët dhe duhet
3 të sqarojë këtu, se versioni serb i transkriptit është hequr
4 nga mocioni ynë i rregullës 154, por ne synojmë që të kërkojmë
5 që të pranohet në provat gjyqësore edhe versioni serb, është
6 dokumenti 000152-TR RED. Versioni anglisht është 000152-TR-ET
7 RED, ndërsa ai në gjuhën shqipe është 000152-TR-AT RED, krahas
8 me shënimin përgatitor, që është ERN 117819 deri në 117821.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
10 kundërshtim?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

12 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Jo.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
15 00152-TR RED si në anglisht dhe në shqip dhe shënimi ERN
16 117819 deri në 117821, të gjitha pranohen në prova gjyqësore
17 dhe duhet t'u caktohet një numër.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
19 deklarata me numër ERN 00152-TR, versioni anglisht dhe shqip,
20 u caktohet numri i provës materiale P01011. Shënimi përgatitor
21 me numër ERN 117819 deri në 117821 do të marrë numrin e provës
22 materiale P01012.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Mund të vazhdoni.

25 Z. BAARLINK: [Përkthim] Në fund të dhjetorit, ZPS-ja

1 dorëzojë një përmbledhje të propozuar të deklaratës tashmë të
2 pranuar sipas rregullit 154 të dëshmitarit, këtë ia dorëzoi
3 Trupit Gjykues, Ekipeve të Mbrojtjes, Mbrojtësit të Viktimave.
4 Dhe Ekipi i Mbrojtjes së Krasniqit propozoi një ndryshim në
5 varësi të kësaj përmbledhjeje.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
7 vazhdoni.

8 Z. BAARLINK: [Përkthim] Sipas asaj që na ka thënë, atë që
9 i ka thënë nëna dëshmitarit më 17 korrik 1998, babai, vëllai,
10 nëna, kunata dhe nipi i sapolindur i dëshmitarit janë ndaluar
11 nga anëtarë të UÇK-së në rrethinat e Rahovecit. Babai dhe
12 vëllai i dëshmitarit u çuan me makinë drejt Malishevës. Ndërsa
13 nëna, kunata dhe nipi i sapolindur u mbajtën në ish-stacionin
14 e policisë së Malishevës për rreth tetë ditë.

15 Nëna e dëshmitarit dëgjonte rënkime që vinin nga burrat
16 të mbajtur në bodrumin e ndërtesës.

17 Të tetën ditë, nëna, kunata dhe nipi i dëshmitarit janë
18 nxjerrë nga ndërtesa dhe janë vendosur në një autobus bashkë
19 me gra dhe fëmijë të tjerë krahas burra serbë me duar të
20 lidhura dhe me kokën ulur.

21 Babai dhe vëllai i Dëshmitarit 498 nuk ishin në autobus
22 dhe dëshmitari nuk i pa më kurrë.

23 Në këtë pikë, nëna, kunata dhe nipi i dëshmitarit janë
24 ndarë nga burrat dhe janë liruar pas pak ditësh.

25 PY. Dëshmitar, do t'ju bëj tashi disa pyetje për vitet pas

1 kidnapimit të anëtarëve të familjes tuaj.

2 Familja jua j e raportoi zhdukjen e vëllait dhe babait
3 tuaj në ndonjë organizatë?

4 PË. Po. Unë ia kam raportuar ICRC-së, *Medecins Sans*
5 *Frontieres*, pra, Mjekëve pa Kufi, policisë tonë dhe disa
6 institucioneve të tjera përkatëse.

7 PY. Ju personalisht a keni marrë pjesë në ndonjë ngjarje
8 publike që lidhet me zhdukjen e tyre?

9 PË. Po. Mora pjesë në kërkime dhe në marshimin e paqes në
10 Dragobil, nga Rahoveci drejt Dragobilës, që është mbajtur aso
11 kohe kur u liruan dy gazetarë dhe po kërkonim për të dashurit
12 tanë.

13 PY. A ju kujtohet përafërsisht kur ka ndodhur ky marshim?

14 PË. Në vitin 1998. Mund të ketë qenë tetor a nëntor, nuk më
15 kujtohet, por viti ka qenë 1998 kur ka qenë ende OSBE-ja,
16 William Walker dhe të tjerët. Atëherë është mbajtur.

17 PY. Faleminderit. A ju kujtohet me përafërsi sesa persona
18 kanë marrë pjesë në këtë marshim?

19 PË. Rreth 3000, 4000 persona.

20 PY. Thatë se shkuat nga Rahoveci drejt Dragobilës. A e dini
21 arsyen pse marshimi vazhdoi drejt Dragobilës, pse po shkonte
22 në atë drejtim?

23 PË. Marshimi po shkonte në drejtim të Dragobilës sepse u
24 liruan dy gazetarë në Dragobil edhe William Walker ishte
25 personi që e bëri të mundur lirimin e tyre. Ne shkuam drejt

1 Dragobilës sepse besonim se dhe anëtarët tanë të familjes mund
2 të ishin atje.

3 PY. Faleminderit. Gjatë seancës përgatitore në muajin dhjetor
4 që është në Shënimin Përgatitor numër 1, paragrafi 4, thoni se
5 keni biseduar me mamanë tuaj ditën që e liruan. Dhe po ashtu
6 thatë, se në atë kohë, ajo ju tregoi se çfarë kishte ndodhur
7 gjatë 14 ditëve që i kishin mbajtur të ndaluar. Po ashtu në
8 intervistën për TFHS-në thatë që mamaja ka vdekur në mars të
9 2007.

10 Tani unë kam këtë pyetje, nga mesi i 1998 e deri në
11 momentin e vdekjes së mamasë suaj në vitin 2007, gjatë kësaj
12 periudhe, sa herë fliste ajo për këtë ngjarje?

13 PË. Gati çdo ditë fliste për këtë. Jo çdo ditë, po gati çdo
14 ditë, se kjo ishte tema kryesore e bisedave tona se ne po
15 përpiqeshim të gjenim ku ishte babai dhe vëllai.

16 PY. Thatë që bisedonit gati çdo ditë. Po si niste biseda çdo
17 ditë?

18 PË. Po mamaja ishte e trishtuar, e pezmatuar, donte të dinte
19 ku ishte babai, i biri dhe çdo ditë diskutonte me policinë
20 serbe, me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar, me të gjithë. Sepse ne
21 kishim detyrime ose më saktë kërkonim dhe kjo dilte çdo ditë.

22 PY. Ku jetonit ju në atë kohë?

23 PË. Në Rahovec, në Kosovë.

24 PY. Jetonit bashkë apo të ndarë.

25 PË. Jetonim të gjithë bashkë, në të njëjtën shtëpi.

1 PY. Në atë kohë, flasim për periudhën mes 1998 dhe 2007, a
2 ndryshoi ndonjëherë mamaja versionin e ngjarjeve?

3 PË. Jo, sepse ka treguar veç të vërtetën, atë që ka
4 përjetuar.

5 PY. Në ndonjë moment, a morët ndonjë konfirmim që babai dhe
6 vëllai juaj nuk jetonin më?

7 PË. Po. E morëm këtë konfirmim në 2007, një muaj para se të
8 vdiste mamaja, na thanë që u gjet ADN-ja mes disa mbetjeve
9 mortore dhe që, në fakt, ishin mbetje mortore të vëllait dhe
10 të babait tim.

11 PY. Si u ndjetë ju?

12 PË. Ishte shumë e vështirë. Kishim shumë shpresa se ishin
13 ende gjallë. Sidoqoftë nuk ishte kështu. Është e
14 papërshkrueshme. Si t'ua tregoj? Është shumë e vështirë.

15 PY. Në atë kohë ende jetonit me mamanë?

16 PË. Po, po, ende jetonim me mamanë. Kur na e dhanë këtë
17 informacion mamaja u sëmure menjëherë pas kësaj dhe një muaj
18 pas kësaj vdiq.

19 PY. Po mamaja si reagoi kur e mori këtë lajm?

20 PË. S'e përballoi mirë. U sëmure edhe në mars vdiq. Pati disa
21 sëmundje edhe vdiq në mars. Të gjithë kishim shpresuar se
22 ishin ende gjallë sepse të gjithë thonin ka mundësi të jenë
23 gjallë, mund të jenë diku në disa miniera, bëjnë punë. Kishim
24 shumë shpresa, por nuk ishte e vërtetë. Dhe unë i mora eshtrat
25 e tyre në muajin qershor.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W00498 (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Baarlink

Faqe 17

1 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

2 Z. BAARLINK: [Përkthim] Kaq pyetje kisha unë për
3 dëshmitarin. Në këtë moment mbase duhet të dorëzoj materialin
4 me informacionin e mbrojtur për t'u pranuar.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
6 çaktivizuar].

7 Keni kundërshtime për këtë fletë?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

9 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

11 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

13 Fleta me informacionin e mbrojtur që është përdorur gjatë
14 dëshmisë së dëshmitarit pranohet dhe merr numrin e provës
15 materiale.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
17 informacioni merr numrin e provës materiale P01013.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
19 Pranohet. Faleminderit.

20 Z. Ellis.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Më jepni vetëm një çast ju lutem.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
23 Gjykatës, serbishtja, anglishtja, pra, a janë pranuar në të
24 gjitha gjuhët, serbisht, shqip dhe anglisht?

25 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës

Dëshmitari: W00498 (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 18

1 këshillohen]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Pyetje të palës tjetër nga Z. Ellis:

4 Z. ELLIS: [Përkthim]

5 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitar. Unë jam Aidan Ellis dhe jam një
6 nga avokatët mbrojtës të z. Jakup Krasniqi.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] Do ju lutesha që fillimisht të
8 kalonim në seancë private për mbrojtjen e emrit të
9 dëshmitarit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

11 Sekretare e Gjykatës, kalojmë në seancë private.

12 [Seancë private]

13 [Seancë private teksti i fshirë]

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të

11 hapur.

12 Z. ELLIS: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, do t'ju bëj disa pyetje lidhur me deklaratat e

14 mëparshme që keni dhënë në vitin 2013, ato që ua tregojë sot

15 paradite edhe Prokuroria.

16 Në kohën që keni dhënë këto deklaratat në vitin 2013, ju

17 keni thënë që punoni për [REDAKTUAR], kështu

18 është?

19 PË. Kështu.

20 PY. Punoni ende aty?

21 PË. Po.

22 PY. Çfarë pune keni, çfarë titulli keni?

23 PË. Puna që bëj unë [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR].

25 PY. A ju ka këshilluar punëdhënësi juaj që të jepnit një emër

1 tjetër kur të jepnit dëshmi këtu sot?

2 PË. Jo. [REDAKTUAR].

3 PY. Do t'ju pyes për situatën në zonën e Rahovecit në korrik
4 të vitit 1998. Në deklaratën e 2013, keni thënë që popullata
5 ka qenë e përzierë, por nuk e dije saktësisht sesa ishte
6 përqindja e këtyre grupeve. A ju kujtohet që e keni thënë këtë
7 në vitin 2013?

8 PË. Po, më kujtohet. Kishte më shumë shqiptar sesa serb.

9 PY. Në 2013, ju thatë që mund të ishin rreth 15.000 shqiptarë
10 dhe rreth 4 apo 5000 serbë. Kështu?

11 PË. Nuk e di me siguri a është e saktë, po ka pasur më shumë
12 shqiptarë sesa serbë. A kanë qenë 15.000 apo 4000 nuk mund ta
13 them me siguri këtë.

14 PY. Mamaja juaj nuk fliste shqip në korrik të 1998, apo jo,
15 nuk fliste mirë shqip në korrik të 1998?

16 PË. Po. Nuk fliste shqip fare.

17 PY. Ndërkohë që situata u bë më e tensionuar në atë zonë,
18 policia serbe ju jepte armë civilëve në zonën e Rahovecit, apo
19 jo, civilëve serbë?

20 PË. Jo. Policia serbe nuk ka dhënë armë.

21 PY. Po familja juaj a mori armë?

22 PË. Të gjithë banorët në moshë madhore kishin marrë armë nga
23 Mbrojtja Territoriale e qytetit, apo që e kishin mbushur
24 moshën.

25 PY. Dhe këtu përfshiheshin dhe anëtarë të familjes tuaj, apo

1 jo?

2 PË. Unë dhe vëllai, po, po jo babai.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund, të lutem, të vendosni në
4 ekran dokument SPOE00201838 dhe nuk është për publikun.

5 PY. Dëshmitar, a mund të shihni në ekran këto shtatë emrat që
6 mbajnë mbiemrin tuaj? Dokumenti nuk është për publikun dhe nuk
7 dua që ta them mbiemrin tuaj, po shihni këtu shtatë emra që
8 kanë mbiemrin tuaj?

9 PË. Po, e shoh.

10 PY. Tek këto emrat a shihni dhe emrat e anëtarëve të familjes
11 tuaj?

12 PË. Shoh emrin tim. Emri im është këtu. Dhe askush tjetër
13 prej familjes sime.

14 PY. Këtu është, këtu lexon "Lista e armëve në Rahovec". Pra,
15 a keni marrë ju armë, ju thatë, nga Mbrojtja Territoriale në
16 atë kohë, kështu?

17 PË. Ju thashë, kisha marrë armë në 1992 kur përfundova
18 ushtrinë, shërbimin e detyrueshëm ushtarak.

19 PY. Në rregull.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Do lutesha të shfaqej në ekran prova
21 materiale 01011. Edhe ky dokument nuk është për publikun. Në
22 anglisht është faqja 25, ndërsa në serbisht është faqja 24.

23 Faleminderit. Shkojmë më poshtë tek anglishtja për të parë
24 rreshtin 22. Besoj se serbishtja fillon në rreshtin 4.

25 Faleminderit.

1 PY. Dëshmitar, ju kanë bërë një pyetje në vitin 2013 lidhur
2 me anëtarët e UÇK-së në atë zonë se kush ishin këta dhe ju
3 jeni përgjigjur:

4 "Të gjithë ishin".

5 E shihni këtë te deklaratata?

6 PË. Po dhe i qëndroj kësaj, 90 për qind ishin anëtarë.

7 PY. Më tej thoni se thoni:

8 "Nëse nuk ishin të përfshirë fizikisht, i ndihmonin
9 financiarisht ose në mënyra të tjera, pra, të gjithë ishin të
10 përfshirë".

11 A ju kujtohet që e keni thënë këtë?

12 PË. Po, e kam thënë. Dhe i qëndroj.

13 PY. Po ju nuk i njihnit personalisht të gjithë shqiptarët në
14 zonën e Rahovecit, Dëshmitar, apo jo?

15 PË. Jo.

16 PY. Ju sqaruat, ju thatë në mëngjes që ishin rreth 15.000
17 mijë shqiptarë në atë zonë, kështu?

18 PË. Mbase dhe më shumë. Siç ju thashë, nuk e di me siguri.

19 PY. Por ama nuk thatë sa prej tyre kanë qenë të përfshirë
20 fizikisht në UÇK, apo jo?

21 PË. Po s'e di me numër të saktë. S'mbaja procesverbal.

22 PY. Dhe ju nuk e dini sesa prej këtyre 15.000 e ndihmonin
23 financiarisht UÇK-në, apo jo?

24 PË. E nga ta di unë këtë. S'i mbaja unë llogaritë e tyre.

25 PY. Kështu. E drejtë. Dhe ju thatë që është dhe një kategori

1 tjetër që shqiptarët ndihmonin UÇK-në dhe në forma të tjera,
2 pra, të gjithë ishin të përfshirë. Ju kujtohet që e keni thënë
3 këtë?

4 PË. Po.

5 PY. Ky është një përgjithësim nga ana juaj sepse, siç i thatë
6 vetë hetuesit, që për mua të gjithë shqiptarët janë njësoj
7 keni thënë?

8 PË. Pothuajse, të paktën lidhur me këtë çështje.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Do lutesha të ktheheshim në faqen 24
10 në anglisht dhe faqja 22 në shqip. Tek serbishtja fillon në
11 rreshtin 16 dhe rreshti 8 në anglisht.

12 PY. Kur keni folur për sulmin që ka ndodhur në Rahovec, keni
13 thënë se garantuat se Ismet Tara dhe Sabahudin Cena keni thënë
14 ishin ndër drejtuesit e këtij sulmi, ju garantoj. Ju kujtohet
15 që e keni thënë këtë?

16 PË. Po, e kam thënë.

17 PY. Dhe baza për këtë garanci që jepni ju është se keni parë
18 Ismet Tarën që po diskutonte me serbët në komunitetin rom pas
19 luftës në korrik ose në gusht të 1998, kështu?

20 PË. Po, negocioi, po nuk ishte kjo baza. Baza ishte që të
21 gjithë shqiptarët thonin që Ismet Tara është komandanti
22 kryesor.

23 PY. Po shohim atë që keni thënë në vitin 2013. Më duket se
24 është rreshtat 1 deri 3 në serbisht tek faqja tjetër. Tek
25 anglishtja thuhet, ju është bërë një pyetje:

1 "Pse jeni kaq i sigurtë?"

2 Dhe ju jeni përgjigjur:

3 "Sepse e di që pas luftës ata po i bënë negociatat me
4 anën serbe dhe me romët".

5 Ajo që keni thënë në 2013 është që kjo është arsyeja se i
6 keni parë që negocionin. A s'është kështu, Dëshmitar?

7 PË. Kam thënë që kanë negociuar me komunitetin rom jo me
8 komunitetin serb. S'ka negociuar asnjëherë ai me serbët.

9 PY. Po kur shikon dikë në verë të 1999 në një zonë nuk do të
10 thotë që ka qenë domosdoshmërisht ky person drejtuesi në 1998,
11 një vit më herët, apo jo?

12 PË. Thashë bazuar në atë që kisha dëgjuar nga shqiptarët që e
13 njihnin, ata thonin që Ismet Tara është një nga udhëheqësit
14 dhe komandantët. Nuk e kam thënë këtë thjesht se e kam parë të
15 negocionte me komunitetin rom.

16 PY. Ju as nuk keni qenë në takimin e verës së 1999,
17 Dëshmitar, apo jo, me komunitetin rom?

18 PË. Jo, nuk kam qenë.

19 PY. Dhe kur ju kanë bërë pyetje:

20 "Ju keni thënë që ata kanë bërë në negociata".

21 Pyetja ishte:

22 "Në emër të kujt i kanë bërë këto negociata?"

23 Ju jeni përgjigjur:

24 "Në emër të shqiptarëve apo të UÇK-së, nuk e di".

25 Kështu?

1 PË. Nuk e kuptova pyetjen tuaj. Çfarë? Ku thuhet kjo që
2 paskam thënë kështu?

3 PY. Tek anglishtja shohim rreshtin 16 deri në 18. Do përpiqem
4 që të gjejë edhe paragrafin korrespondues në serbisht.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund të jetë tek faqja pararendëse,
6 një faqe më përpara? Është në fillim të faqes, në fillim të
7 faqes, rreshti 1, tek rreshti 1.

8 PY. Pyetja ka qenë kjo:

9 "Ju thoni se po kryenin negociata po në emër të kujt?"

10 Ju jeni përgjigjur:

11 "Në emër të shqiptarëve ose të UÇK-së, s'e di".

12 PË. Po, kështu. Bënin negociata me romët, po jo me mua apo me
13 palën serbe.

14 PY. Por ju nuk e njihnit personalisht Ismet Tarën apo
15 Sebahudin Cenën, apo jo?

16 PË. I njihnja, nuk i njihja personalisht, po i kisha parë se
17 Ismet Tara kishte një qebaptore, ndërsa Sebahudin Cena punonte
18 në fabrikën 18 Nëntori.

19 PY. Ajo që i keni thënë ju intervistuesit sa i takon
20 udhëheqjes së UÇK-së në Rahovec ka qenë e mbështetur në
21 thashetheme apo gjëra që ju i kishit dëgjuar përmes personave
22 të tjerë, kështu?

23 PË. Kështu. Unë s'kam qenë anëtar i tyre që t'i dija të
24 gjitha gjërat.

25 PY. Pra, nuk kishe ndonjë dijeni personale për strukturën e

1 UÇK-së në zonën e Rahovecit në korrik të 1998, apo jo?

2 PË. Kisha informata prej shokëve shqiptarë që ma kishin
3 treguar. Personalisht nuk kisha marrë pjesë në asnjë prej
4 takimeve.

5 PY. Pra, nuk kishit dijeni personale, thjesht kishit dëgjuar
6 persona të tjerë që e thonin këtë kështu?

7 PË. E kam dëgjuar prej personave të tjerë, siç ju thashë prej
8 shqiptarëve, që mbase merrnin pjesë në këto takime, po asnjë
9 s'e pranon tani. Sabahudin Cena ka qenë udhëheqës politik
10 sepse mbante takime edhe shfaqej në gazeta. Kumtesat e tij
11 politike dilnin në gazeta

12 PY. [Mikrofoni çaktivizuar]

13 Po flasim për ngjarjet e 17 korrikut 1998. A është e
14 drejtë që atë ditë, pra, atë ditë ju po punonit në fabrikën e
15 Tërnovës dhe më pas shkuat që të hanit drekën, punuat deri në
16 3.00 të pasdites dhe shkuat që të hanit drekë?

17 PË. Pas punës shkova në shtëpi edhe hëngra drekë.

18 PY. Pastaj luajtët futboll dhe nga ora 5.00, 6.00 dëgjuat të
19 shtëna dhe një polic ju tha të shkonit në shtëpi, kështu?

20 PË. Kështu.

21 PY. Dhe ju shkuat në shtëpi?

22 PË. Po, shkova në shtëpi. Gjatë kohës që isha në punë fola me
23 prindërit, më morën në telefon dhe më thanë që ishin duke u
24 larguar.

25 PY. Po ju ama nuk ishit, nuk e patë me sytë tuaj atë që ju

1 ndodhi anëtarëve tuaj të familjes në Rahovec, apo jo?

2 PË. Nuk pashë kur ma rrëmbyen familjen. Mamaja ka qenë atje.

3 Ajo i pa të gjitha sepse ajo ishte një nga personat që u

4 rrëmbye njësoj bashkë me kumatën time.

5 PY. Po siç e keni konfirmuar në 2013, çdo gjë që ju po thoni

6 është e mbështetur në atë ju ka thënë mamaja, apo jo, çdo gjë

7 ua ka thënë mamaja nuk e keni parë ju vetë?

8 PË. Atë që më ka thënë mamaja për rrëmbimin është 100 për

9 qind e vërtetë. Unë nuk e pashë me sytë e mi. Nuk e pashë

10 momentin e rrëmbimit, s'e pashë personalisht. Mamaja ma tha

11 këtë histori.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] [Nuk ka përkthim]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

14 Do të bëjmë pushimin që e diskutuam më herët për dhjetë

15 minuta.

16 Do t'ju nxjerrim jashtë sallës së gjyqit.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi akoma në

20 seancë publike. Bëjmë një pushim dhjetë minutësh. Ju lutem

21 kthehuni në sallën e gjyqit në 10.10 minuta. Seanca

22 ndërpritet.

23 --- Seanca ndërpritet në orën 10.01

24 --- Seanca rifillon në orën 10.13

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

1 sillni dëshmitarin në sallë.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 Dëshmitar, jemi gati të vazhdojmë.

5 Z. Ellis e keni fjalën ju.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

7 PY. Dëshmitar, u ndërpre në momentin kur konfirmove që nuk ke
8 qenë dëshmitar i asaj që i ka ndodhur anëtarëve të familjes
9 tuaj. Ju nuk e keni parë personalisht. Por ke thënë atë që ju
10 ka treguar nëna.

11 PË. Nuk po më vjen përkthimi.

12 PY. A më dëgjoni tani?

13 PË. Po, ju dëgjoj. Mund ta përsërisni pyetjen, ju lutem?

14 PY. Sigurisht. Kur ju ndërpre përpara pushimit që sapo bëmë,
15 ju konfirmuat që ju nuk keni qenë dëshmitar i asaj që ka
16 ndodhur pjesëtarëve të familjes tënde. Nuk e keni parë këtë
17 gjë personalisht. Por keni treguar historinë që ka treguar
18 nëna juaj. Është kjo?

19 PË. Saktë. Kështu është.

20 PY. Kërkoj ndjesë që t'ju kthej në kujtime të dhimbshme. Por
21 nëna juaj vdiq në mars të 2007, apo jo?

22 PË. Po, kështu është.

23 PY. Lexova intervistën tuaj të 2013 dhënë Task Forcës

24 Hetimore, nuk i keni përmendur në intervistë shënimet me

25 shkrim në atë kohë, apo jo?

1 PË. Saktë, kështu është. Përveç faktit që dhe nëna ime ka
2 dhënë deklaratë Gjykatës Ndërkombëtare dhe të gjithëve, por
3 nuk i kam lexuar këto.

4 PY. Do të kthehemi tek kjo deklaratë më vonë. Por ju nuk keni
5 mbajtur shënim të asaj që ju ka treguar nëna në atë kohë, a
6 është kështu?

7 PË. Jo.

8 PY. Atëhere në momentin e intervistën të 2013, ju jeni
9 përpjekur të kujtoheni sa më mirë atë ju kishte treguar nëna
10 para gjashtë vitesh, a është kështu?

11 PË. Nëna më ka treguar deri në fund të jetës së saj. Për atë
12 kohë sa ishte gjallë, më ka treguar vazhdimisht në mënyrë të
13 përsëritur çdo ditë të njëjtën histori dhe unë i qëndroj
14 vërtetësisë të tregimit të saj.

15 PY. Ngjarjet e korrikut të 1998 duhet të kenë qenë shumë të
16 rënda për nënën tuaj dhe ajo ka vuajtur, ka patur dhe ka qenë
17 në gjendje emocionale të brishtë në momentin që ka dhënë
18 deklaratat autoriteteve, apo jo?

19 PË. Nuk është e vërtetë. Nëna ime ka qenë një grua
20 jashtëzakonisht e guximshme dhe e fortë, ka dhënë deklaratat
21 duke qenë e qartë në mendjen e saj dhe deklaratat e saja kanë
22 qenë 100 për qind të vërteta.

23 PY. Nëna juaj ishte bashkë me djalin e saj në intervistën që
24 ka dhënë UNMIK-ut në Beograd në qershor të 2006. A ishit ju që
25 e keni shoqëruar atë në këtë takim?

1 PË. Po. Kudo që ka shkuar ka shkuar me mua.

2 PY. Kemi një shënim të kësaj interviste që ka numrin

3 SPOE0019931 në faqen numër 2. Nuk ka nevojë ta shfaqim në

4 ekran. Por personi që ka regjistruar këtë intervistë ka thënë:

5 "Intervista ishte e plotë, e tërësishme. Edhe pse nëna

6 juaj u ankua për numrin e madh të intervistave që kishte dhënë

7 më parë edhe pse herë pas here e kapnin emocionet dhe që nuk

8 pranoi për më shumë se 45 minuta që të shikonte fotografitë e

9 personave që paraqitur."

10 Është kështu, a është një pasqyrim i intervistës në 2006

11 në të cilën keni marrë pjesë edhe ju?

12 PË. Nuk e di saktësisht. Nuk mund ta pohoj këtë, por është e

13 mundur të ketë ndodhur. Nuk e di për cilën intervistën e keni

14 fjalën.

15 PY. Intervista në 2006 me UNMIK-un në 2006, në Beograd ku

16 keni qenë edhe ju që e keni shoqëruar atë, z. Dëshmitar.

17 PË. A nuk ka qenë më herët kjo gjë? Sepse kam dyshime për

18 vitin 2006.

19 PY. Po gjithsesi ju ishit personi që e ka shoqëruar atë në

20 momentet kur ka shkuar për të dhënë deklaratat, a është kështu?

21 PË. Po, me siguri unë sepse unë kam qenë i vetmi që ka shkuar

22 me të. Tani a ka qenë ky vit apo jo, nuk mund ta them me

23 siguri.

24 PY. E lëmë vitin mënjane për momentin, pyetja ime është e

25 saktë që keni shkuar me të, kur keni shkuar me të për

1 intervista herë pas here ajo ka pasur momente të vështira
2 emocionale për shkak të asaj që kishte, të gjërave që po
3 bisedonte? A është kështu?

4 PË. Jo, nuk është e vërtetë.

5 PY. Në shënimin e intervistës pasqyrohet kështu. Ju prapë nuk
6 pajtoheni me intervistën lidhur më këtë shënim të intervistës?

7 Z. BAARLINK: [Përkthim] Kundërshtojmë këtë gjë. Nuk ka
8 bazë për këtë pyetje.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk pajtohem me këtë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Hidhet
11 poshtë, rrëzohet kundërshtimi.

12 Vazhdoni me pyetjet, z. Ellis.

13 Z. ELLIS: [Përkthim]

14 PY. Pyetja ishte: Shënimet e intervistës, procesverbali i
15 intervistës shënon që nëna kishte momente ku emocionohet rëndë
16 dhe pyetja ime është a nuk pajtoheni me këtë?

17 PË. Sigurisht që ka qenë e vështirë sepse ajo nuk e dinte
18 sesi kishin përfunduar djali dhe burri i saj. Dhe shikoi të
19 gjitha fotografitë, natyrisht që në qoftë se ata i kanë
20 treguar fotografinë, natyrisht që ka ndodhur.

21 PY. Dëshmitar, e kuptoj që nuk ishit aty dhe i keni thënë
22 Gjykatës atë që ju kujtohet që ju kujtohet që ju ka thënë
23 nëna, por po ju pyes, pyetjet e mia janë për hollësi të
24 ngjarjeve të vitit 1998. Më kuptoni?

25 PË. Ju kuptoj. Dhe s'ka problem fare.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të kalojmë atëherë tek
2 dokumenti P01011. Edhe ky dokument nuk ka nevojë të shfaqet
3 për publikun. Është vetëm për nevoja vetëm brenda sallës së
4 gjyqit. Është faqja 6 në dy versionet edhe në anglisht edhe
5 serbisht. Mendoj që është rreshti 12, 13 në serbisht dhe
6 rreshti 20 në versionin në anglisht.

7 PY. Juve ju kanë thënë që në momentin kur vëllai juaj e ndali
8 makinën 50 apo 60 luftëtarë "aq sa kanë qenë" dolën nga pylli.
9 A ju kujtohet që keni thënë këtë gjë?
10 PË. Po, më kujtohet.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të shfaqni në ekran ju lutem
12 SPOE00195761 dhe mendoj se në versionin në anglisht është
13 U000-0211. As ky dokument nuk ka nevojë të shfaqet për
14 publikun. Në fakt, duke patur parasysh masat mbrojtëse që
15 zbatohen aktualisht, të gjitha dokumentet që do përdorë duhet
16 të shfaqen vetëm në sallën e gjyqit dhe jo për publikun.

17 Paragrafi i katërt në versionin në anglisht, më duket se
18 vazhdon në faqen vijuese, në faqen tjetër në versionin në
19 serbisht. Po, paragrafi i katërt në këtë faqe.

20 PY. Dëshmitar, kjo është nga deklaratat e nënës tuaj që i ka
21 dhënë gjykatësit hetues në Beograd në qershor të vitit 2000. E
22 shikoni pjesën ku thotë:

23 "Një kilometër para se të mbërrinim në Rahovec rreth
24 dhjetë terroristë shqiptar të veshur me uniforma të UÇK-së dhe
25 të armatosur me armë, dolën përballë makinës tonë".

1 E shikoni këtë deklaratë, Dëshmitar?

2 PË. Po, e shoh.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të kalojmë tek K019 në faqen
4 e dytë, pra, K0195141. Kërkoj ndjesë janë dy dokumente të
5 ndryshme, është dokumenti i TPNJ-së që mban numrin K0195141.
6 Kemi vetëm versionin në anglisht për këtë dokument, paragrafi
7 i tretë në faqen e dytë, ju lutem.

8 PY. Dëshmitar, këtu ju e dinë që nëna juaj ka dhënë deklaratë
9 Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, a është
10 kështu?

11 PË. Ndoshta me siguri ka dhënë. Se ka dhënë shumë deklarata.
12 Nuk e di, nuk i njoh të gjithë organizatat të cilave iu ka
13 dhënë deklaratë, po sigurisht që ka dhënë.

14 PY. Në këtë deklaratë ajo thotë:

15 "Nuk mund t'ju them saktësisht sa vetë ishin të gjithë së
16 bashku, megjithatë pesë apo gjashtë prej tyre rrethuan makinën
17 tonë".

18 Dëshmitar, nëna juaj nuk ishte e sigurtë sesa burra, sesa
19 meshkuj ishin aty në momentin që ka ndodhur kjo?

20 PË. Ajo ka treguar, ka folur për ata që ishin me uniformë,
21 por ka patur edhe civilë që mbanin armë. Ka thënë rreth dhjetë
22 prej tyre që ishim me uniformë, ndërsa nuk ka dhënë numër për
23 civilët që ishin të armatosur sepse nuk mund t'i numëronte për
24 momentin. Ata që kanë rrethuar makinën kanë qenë pesë, gjashtë
25 apo dhjetë. Nuk mund të jenë 50 vetë që rrethojnë makinën

1 PY. Numrat që ka dhënë ajo në këtë deklaratë janë shumë
2 ndryshe nga 50 apo 60 që keni dhënë ju në deklaratën tuaj, a
3 është kështu? Thjesht "po" ose "jo". Dallimi është i madh pra.

4 PY. Në letër, po. Po në realistet nuk është kështu.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument nga
6 ekрани. Faleminderit.

7 PY. Tani, z. Dëshmitar edhe pyetjet që do t'ju bëj tani mund
8 t'i jepet përgjigje me "po" ose "jo".

9 Ju thatë që nëna ju ka treguar për një person që quhej
10 Jakup Hoti në vendin e ndalimit në Malishevë që ishte nga
11 Caralluka, apo jo?

12 PË. Po, kështu është.

13 PY. Nëna të ka thënë që ky person e ka trajtuar atë mirë,
14 është kështu?

15 PË. Kështu është.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund t'i kthehemi deklaratës tuaj
17 që është P01011, faqja 11 në anglisht dhe faqja 10 në
18 versionin në serbisht. Rreshtat 14, 16 në serbisht dhe 5 deri
19 në 8 në versionin në anglisht.

20 PY. Ajo që keni thënë ju këtu, kjo është deklarata juaj,
21 Dëshmitar. Këtu keni thënë se --

22 Z. ELLIS: [Përkthim] E përsëris që nuk duhet të shfaqet
23 për publikun kjo gjë.

24 PY. Këtu keni thënë nëna juaj "ka pyetur Hotin lidhur me
25 babain dhe vëllain e tim ditën e tretë apo të katërt ..."

1 Dhe:

2 "Bazuar në atë që ka thënë, bazuar në përshkrimin e
3 rrobave e kështu me radhë ...".

4 A ju kujtohet që keni thënë këtë në deklaratën tuaj?

5 PË. Po, më kujtohet.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të kthehemi tek 019594 që
7 është deklarata e nënës, që nëna juaj i ka dhënë TPNJ-së? Në
8 faqen 3, ju lutem. Paragrafi 3.

9 PY. Ajo që nëna juaj i ka deklaruar TPNJ-së lidhur me këtë në
10 deklaratë e ka përmendur Jakup Hotin me emër. Aty dhe thotë:

11 "Në këtë ndërtesë pyeta njërin prej rojeve lidhur me
12 burrin dhe djalin dhe ai më thanë që ata mbaheshin të ndaluar
13 në ndërtesën numër 2. Duke përshkruar rrobat e burrit dhe
14 djalit në mënyrë të hollësishme ..."

15 Pra, ajo që nëna juaj i ka thënë TPNJ-së është që nuk i
16 ka thënë Jakup Hoti, i ka treguar për burrin dhe djalin por
17 një rojë aty. Kjo është ndryshe nga ajo që keni deklaruar ju,
18 apo jo?

19 PË. Një rojë apo quheni si të doni. Ai që hapte derën e
20 dhomës ku ishin, emri i tij ishte Jakup Hoti, ky ishte nga
21 Caralluka. Këtu thotë Jakup Hoti. Nuk mund të lexoj anglisht
22 po në këtë paragraf shihet.

23 PY. Kjo është ajo që doja të thoja. Por në qoftë se keni
24 nevojë do t'jua lexoj në anglisht dhe do ta dëgjoni në
25 serbisht. Dhe kjo është tamam çështja. Në momentin që nëna

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W00498 (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 36

1 juaj përmendi Jakup Hotin e përdori me emër sepse e njihte
2 emrin. Ndërsa kur u pyet më vonë pastaj tha njëri prej rojeve,
3 nuk e përmendi Jakup Hotin aty?

4 PË. Nëna më ka thënë që Jakup Hoti ishte personi që hapte dhe
5 mbyllte derën e qelisë apo dhomës, quheni si të doni. Ai ishte
6 i vetmi që ishte aty dhe mbante veshur një lloj uniforme. Dhe
7 ai u prezantua vetë duke thënë që quhej Jakup Hoti dhe se
8 ishte nga Caralluka.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të kalojmë tek SPOE00194062
10 që është versioni në anglisht. Ndërsa në serbisht është
11 SITF00062645. Në versionin në anglisht është faqja 194071,
12 pyetja 59. Në serbisht është SITF00062654.

13 PY. Tani, z. Dëshmitar, kjo është pjesë e intervistës së
14 nënës tuaj dhënë UNMIK-ut në 2006, që përmendëm më herët. Dhe
15 aty ajo thotë se:

16 "... burrat që na thanë neve, që rrinin përpara derës si
17 roje, që përshkruan rrobat që kishte veshur burri dhe djali
18 im".

19 Pra, këtu ajo nuk i referohet një personi, Jakup Hotit
20 për shembull. Po flet për meshkujt, burrat që ishin aty që
21 bënë roje, apo jo?

22 PË. Kështu lexon këtu. Por unë po ju them, ndoshta në atë
23 kohë nuk i dinte emrin e tij, por më vonë ajo tha që ai quhej
24 Jakup Hoti dhe ishte nga Caralluka dhe që ishte personi që e
25 ka ndihmuar atë. Jo vetëm atë, por ka sjellur pelena për bebin

1 e kështu me radhë.

2 Pra, Jakup Hoti i ka sjellur pelenat, pampersat për
3 fëmijët, ushqim, qumësht dhe kështu është prezantuar vetë ai.
4 PY. E kuptoj këtë, z. Dëshmitar. Thjesht unë po krahasoj dy
5 versionet, deklaratat që ju thoni që ka thënë nëna dhe atë që
6 ka thënë vetë nëna në deklaratat e saj. Dhe ka një dallim, apo
7 jo, sepse ju thoni që ajo ka thënë që ka qenë që Jakup Hoti i
8 ka përshkruar rrobat që kanë pasur veshur ata, ndërsa në dy
9 deklaratat e tjera që ju shikoni thotë që njëri prej rojeve e
10 ka bërë këtë gjë?

11 PË. Tani, roja ka qenë ai vetë, Jakup Hoti.

12 PY. Z. Dëshmitar, ju e keni pohuar më herët që nuk keni qenë
13 aty. Ju thjesht po raportoni atë që nëna ju ka treguar juve, a
14 është kështu?

15 PË. Kështu është.

16 PY. Dhe tani unë po ju tregoj atë që nëna ka deklaruar dhe ka
17 një dallim aty, apo jo?

18 PË. Nuk ka dallim. Ju po më tregoni pesë dokumente. Njëri
19 prej tyre përmend Jakup Hotin, i dyti nuk e përmend, i treti e
20 përmend përsëri. Unë po ju them që i vetmi person që i ka
21 ndihmuar ata ka qenë ky. I ka ndihmuar duke u sjellur ushqim,
22 pampers për fëmijën, ndoshta nëna ime ka hezitur ta përmend
23 emrin e tij. Nuk e di si mund ta di unë se pse e ka thënë në
24 këtë mënyrë.

25 PY. Kthehemi te deklaratat juaja, P01011, në rreshtat 19 deri

1 në 21 në anglisht, pra, P01011. Dhe në anglisht është faqja 9,
2 rreshtat 17, 21 në anglisht.

3 PY. Ju thoni këtu, se juve ju kanë thënë se Jakup Krasniqi
4 ishte i ulur mbrapa një tavoline, si një zotëri dhe i ka
5 kërkuar emrat, mbiemrat nënës dhe kumatës tuaj "kush jeni, nga
6 vini, e të tjera ..."

7 A ju kujtohet që keni deklaruar kështu në 2013, z.

8 Dëshmitar?

9 PË. Po, më kujtohet.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] T'i kthehemi atëherë deklaratës që
11 nëna juaj i ka dhënë TPNJ-së me numër K0195141, në faqen e
12 tretë, ju lutem.

13 PY. Edhe kjo deklaratë këtu është në anglisht, do t'jua lexoj
14 unë. Po ajo që nëna juaj i ka thënë Tribunalit Penal
15 Ndërkombëtar është se:

16 "Në mëngjes ne të treve na çuan tek një burrë që e kishte
17 zyrën në katin e parë. I veshur me tesha civile, ai donte të
18 na pyeste vetëm për të dhënat personale. Pas pak ditësh, i
19 veshur me uniformë të zezë na tregoi emrin e vetë që ishte
20 Jakup Hoti ..."

21 Është e qartë, pra, Dëshmitar, se nëna juaj e identifikon
22 personin në zyrë që ia mori të dhënat ermin, mbiemrin e këto
23 me radhë që ishte Jakup Hoti? Kështu është?

24 PË. Jakup Hoti kishte të veshur një uniformë të zezë dhe
25 ishte ai i cili e hapi dhe e mbylli derën e dhomës ku

1 mbaheshin ato. Dhe pastaj këto të dhënat, këto të dhënat i
2 mbajti shënim Jakup Krasniqi i veshur me uniformë me lara,
3 pra, kamuflazh.

4 PY. Po nuk ka thënë kështu nëna juaj, Dëshmitar, sepse këtu
5 thotë se e çuan tek një person që kishte zyrën në katin e parë
6 dhe ky njeri, ky burrë, siç ua tha atyre, e kishte emrin Jakup
7 Hoti. Këtë i ka thënë nëna juaj?

8 PË. Ua thashë, Jakup Hoti ishte emri i burrit që hapte e
9 mbyllte derën e dhomës ku i mbanin. U sillte pelena, qumësht
10 për foshnjën. Dhe kur i liruan i dha dhe dhjetë marka gjermane
11 foshnjës, [REDAKTUAR].

12 PY. Këtë e kuptoj. Na e thatë këtë. Ajo që po ju them është
13 që deklarata që ka dhënë nëna juaj është ndryshe, ndryshon nga
14 këto fjalët që thoni ju, po apo jo?

15 PË. Nuk di se ç'thotë kjo këtu, Se unë nuk e kuptoj këtë. Unë
16 po ju them seç më ka thënë mua. Dhe e dhashë këtë deklaratë në
17 vitin 2013, jo para ca muajsh.

18 PY. Ta lexojmë një herë ndërkohë që e kemi këtu. Kjo është
19 një deklaratë që nëna juaj ua ka dhënë hetuesve të Tribunalit
20 Penal Ndërkombëtar për Jugosllavinë dhe në të thuhet që:

21 "E kaluam natën në një dhomë të ruajtur nga një rojë i
22 veshur me uniformë kamuflazhi. Në mëngjes ne të treve na çuan
23 tek një burrë i cili e kishte zyrën në katin e parë. Ky kishte
24 të veshur tesha civile. Donte vetëm të na pyeste të dhënat
25 personale. Pas pak ditësh, pastaj i veshur me uniformë të zezë

1 ai na tregoi sesi quhej dhe quhej Jakup Hoti ...”

2 Shpresoj që jua përkthyen tani, Dëshmitar, këtë. Dhe unë
3 po ju them edhe një herë se ajo që ka thënë nëna juaj ndryshon
4 nga deklarata që ju keni dhënë në vitin 2013, apo jo?

5 PË. Nuk mund të ketë ndryshim. Jua kam thënë dhe po vazhdoj
6 t’ju them që Jakup Hoti ishte ai që mbyllte dhe hapte derën e
7 qelisë. Jakup Krasniqi ishte ai që u mori të dhënat personale.
8 Unë nuk isha aty. Thjeshtë po ju them se çfarë kam ndigju prej
9 nënës. Po të kisha qenë vetë aty nuk do të isha këtu sot,
10 njësoj si të gjithë burrat e tjerë, meshkujt e tjerë që s’janë
11 më.

12 PY. Po, pra, z. Dëshmitar. Nëna juaj e di më mirë se ajo ka
13 qenë aty dhe e di se kush jua ka marrë të dhënat personale?

14 PË. Po, e saktë. Të dhënat e saj personale i ka marrë Jakup
15 Krasniqi.

16 PY. Po në deklaratën që i ka dhënë TPNJ-së nëna juaj, qartë,
17 thotë se, burri që e kishte zyrën në katin e parë që u mori
18 dhe të dhënat personale quhej Jakup Hoti. Kjo nuk është e
19 njëjta gjë që ju ka thënë juve nëna.

20 PË. Si ka mundësi që në deklaratën e fundit thotë që është
21 Jakup Krasniqi ai që i mbajti shënim të dhënat personale?

22 PY. Po deklarata e fundit është e juaja. Është ajo që keni
23 thënë ju në 2013. Ndërsa kjo është deklarata që nëna juaj i ka
24 dhënë TPNJ-së. Edhe unë këtë po them. Që nuk përputhen ajo që
25 ju keni thënë me atë që ka thënë nëna juaj nëpër deklarata.

1 PY. Nuk ka mospërputhje. Unë po ju them të vërtetën, atë që
2 kam dëgjuar.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë ju lutem të kërkoj që të
4 kemi në ekran U00-5328 në anglishte dhe U000-5040 në
5 serbishte. Edhe një herë nuk janë për t'u shfaqur publikisht.
6 Paragrafi i fundit në faqen e parë në anglishte. Dhe besoj
7 edhe në fund të faqes së parë në serbishte.

8 PY. Dëshmitar, nëna juaj ka folur me policinë serbe, me MUP-
9 in në shtator të 1998, apo jo?

10 PË. Po, kështu është.

11 PY. Ajo që thotë këtu në paragrafin e fundit të deklaratës së
12 saj është se ishte Jakup Hoti ai i cili erdhi dhe filloi që
13 t'i merrte në pyetje dhe të nesërmen ishte përsëri po Jakupi
14 që erdhi t'i merrte në pyetje. Pra, thotë që është Jakup Hoti
15 ai që ju bën pyetje. Kështu thuhet këtu, apo jo?

16 PË. Po unë po ju them, e thotë Jakup Hoti që kishte uniformë
17 të zezë dhe që u prezantua si komandanti i policisë. Me shumë
18 gjasë edhe u ka bërë pyetje, e nga ta di unë? Pastaj vazhdon
19 thotë që i ka ndihmuar, ju ka dhënë ushqime dhe sende të tjera
20 për foshnjën. Ndërsa të dhënat personale ua ka marrë Jakup
21 Krasniqi. Ky nuk i mori në pyetje. Thjesht i pyeti për emrin
22 dhe mbiemrin.

23 PY. Po unë po ju them se Jakup Krasniqi s'ka qenë i pranishëm
24 fare aty gjatë ndalimit ët nënës tuaj dhe nëna juaj nuk ka
25 përmendur që ka qenë Jakup Krasniqi ai që i ka marrë dhënat

1 personale në deklaratat që ajo ka dhënë?

2 PË. Epo e ka thënë. Mbase nuk i kujtohej atëherë, por i vetmi
3 person që ka përmendur që është Jakup Hoti ka përmend Jakup
4 Hotin se ky ka qenë ai që i ka ndihmu.

5 PY. Kalojmë tek deklaratata që i ka dhënë TPNJ-së që është
6 K195141, në atë faqe, faqen e parë. Në këtë deklaratë që i ka
7 dhënë TPNJ-së, nëna juaj ka thënë vërtetë që mendon se ka parë
8 një njeri të quajtur Jakup Krasniqi i cili hyri një herë në
9 dhomë po këtu ajo nuk thotë se ua ka marrë të dhënat
10 personale, Dëshmitar.

11 Do ju tregoj dhe një deklaratë tjetër dhe e kemi
12 deklaratë që është dhe me serbishte.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] SPOE00194062 dhe në serbisht është
14 SITF00062645. Ju lutem, ta nxjerrim në ekran. Por jo
15 publikisht. Është faqja 194077 dhe është në faqen 16 serbisht.
16 Dhe është pyetja 107. Besoj se përgjigja vazhdon në pjesën e
17 sipërme të faqes në vijim.

18 PY. Pra, është pjesa ku nënën tuaj i kanë bërë pyetjen që
19 personi që ajo thotë që ishte Jakup Krasniqi dhe ajo thotë që:

20 "Seç tha diçka në shqip. Nuk e kuptova çfarë. Pastaj
21 doli. Dhe asgjë më shumë".

22 Pra, nuk përmendet që ky u ka marrë të dhënat personal,
23 Dëshmitar?

24 PË. Nuk shoh as pyetje asgjë. Këtu thotë vetëm:

25 "Dëshmitari: Ai tha diçka në shqip".

1 PY. Po mungon pyetja këtu në versionin serbisht. Por ama në
2 përgjigje ajo nuk thotë asgjë që u ka marrë të dhënat
3 personale?

4 PË. Po tashti si të përgjigjem unë kur nuk shoh pyetjen? Këtu
5 shoh vetëm që ka thënë "diçka në shqip".

6 PY. Dëshmitar, unë po ju them se në deklaratën me shkrim që e
7 ka dhënë nëna juaj nuk ka deklaruar asnjëherë që Jakup
8 Krasniqi u ka marrë të dhënat personale apo t'i ketë marrë në
9 pyetje. Kjo nuk përputhet me atë që po thoni ju, kështu?

10 PË. Siç ua shpjegova nëna më ka thënë që Jakup Hoti ishte ai
11 i cili hapte e mbyllte derën e qelisë, i sillte ushqime
12 foshnjës e kështu me radhë. Jakup Krasniqi ka mbajtur shënim
13 të dhënat e atyre. Nuk i mori në pyetje më tej, thjesht u
14 prezantua që jam Jakup Krasniqi "Më jepni të dhënat si quheni,
15 emrin, mbiemrin". Këtë më ka thënë nëna. Nuk po e shpik unë
16 sepse as kisha dëgju për Jakup Krasniqin.

17 PY. Nuk po ju them që po e shpikni ju, unë po ju them që nuk
18 përputhet me atë që ka thënë nëna juaj nëpër deklarata gjatë
19 viteve.

20 PË. S'ka asnjë mospërputhje. 90 për qind është identike.

21 PY. Jeni takuar me Prokurorinë në dhjetor të këtij viti për
22 t'u përgatitur, pra, për një seancë përgatitore. Ju kujtohet,
23 domethënë, në dhjetor?

24 PË. Këtu? Këtu, po, po.

25 PY. Ajo që keni thënë gjatë kësaj seance përgatitore është se

1 ato çka ju ka thënë nëna lidhur me Jakup Krasniqin ishte më
2 vonë të 1998, në gusht të 1998, kur e pa, rreth gushtit,
3 shtatorit, kur e pa në televizor. Ju kujtohet që i keni thënë
4 kështu Prokurorisë?

5 PË. Po, po. Kur e pa Jakup Krasniqin në televizor, tha, "Apo
6 ky është ai i cili na pyeti për emrin e mbiemrin". Këtë
7 thashë.

8 PY. Po në fillim nëna juaj ju tregoi se çfarë i kishte
9 ndodhur në korrik të 1998, pra, me t'u takuar. Kështu?

10 PË. Po, kështu është.

11 PY. Po ju thoni që ajo jua ka përmendur emrin e Jakup
12 Krasniqit më vonë diku nga gushti dhe shtatori i 1998, kështu?

13 PË. E ajo e ceku këtë njeri, por nuk i kujtohej emri. Kur e
14 pa pastaj në televizor në lajme tha, "Ky është ai që na ka
15 pyet për emrin dhe mbiemrin".

16 PY. Po mirë. Ti marrim me radhë këto.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Kalojmë tashti, kthehemi tek
18 dokumenti me numër P01011, jo për t'u shfaqur publikisht, në
19 faqen 10 në anglisht dhe në faqen 9 në serbisht. Rreshtat 15
20 deri 18 në anglisht. Dhe faqja 9, rreshti 25 -- jo, më falni
21 do të na duhet të kalojmë tek faqja tjetër pjesën e sipërme në
22 serbisht.

23 PY. Këtu në intervistë në vitin 2023 ju është bërë pyetje:

24 "Nga e mori vesh ajo që personi i cili i pyeti për të
25 dhënat personale ishte Jakup Krasniqi?"

1 Dhe ju i jeni përgjigjur kështu:

2 "Ua tha ai, ua tregoi këtë gjatë marrjes në pyetje, u
3 prezantu".

4 Kështu keni thënë në 2013?

5 PË. Po, po. Kështu është. Kështu kam thënë. Tha "Jam Jakup
6 Krasniqi".

7 Z. ELLIS: [Përkthim] Kalojmë tani tek faqja 8 në të dy
8 gjuhët? Po, në fakt, s'ka nevojë.

9 PY. Pra, ju në vitin 2013 nuk keni thënë në asnjë pjesë të
10 kësaj deklaratë që nëna juaj e pa apo ju vetë e patë Jakup
11 Krasniqin në televizor?

12 PË. Po s'më pyetën për këtë. Unë përditë e shikoja në
13 televizor se ishte, dilte në televizor përditë. Po nuk thashë
14 që kam folur me të.

15 PY. Po jo, ato jua kanë bërë këtë pyetje:

16 "Nga e mori vesh ajo që ishte Jakup Krasniqi ai që i
17 kishte marrë të dhënat personale?

18 Dhe ju nuk keni dhënë përgjigje këtu që e kishe parë në
19 televizor në gusht a në shtator të 1998?

20 PË. Ai u prezantu, siç ua thashë. Tha "Jam Jakup Krasniqi. Më
21 thoni emrin dhe mbiemrin si quheni?" Këtë pyetje ju bëri. Unë
22 nuk po them se i mori në pyetje, por mbajti shënim emrin
23 mbiemrin në bllokun e vet.

24 PY. Dëshmitar, unë nuk ju bëra këtë pyetje. Pyetja që ju bëra
25 ishte kjo: Në vitin 2013, kur keni dhënë këtë intervistë, ju

1 është bërë pyetja:

2 "Nga e mori vesh ajo që personi që i mori të dhënat
3 personale ishte Jakup Krasniqi?"

4 Ju nuk e cekët punën e televizorit?

5 PË. Por mbase nuk e kam cekë atëherë. Por siç ua thashë,
6 atëherë ai ishte prezantuar dhe u kishte tregu këtyre se ishte
7 Jakup Krasniqi.

8 PY. Po, por herën e parë që ju keni thënë se nëna juaj ua
9 përmendi që ishte Jakup Krasniqi ishte pas 25 vjetësh, pra,
10 para një muaji kur jeni takuar me Prokurorinë, kështu?

11 PË. Tani nëna më ka vdekur në vitin 2007. Si mund ta cekja
12 unë këtë më herët? Dy ditë pasi erdhën, mbasi i çuan në
13 Malishevë, ata erdhën, u morën të dhënat dhe kjo më tha që ky
14 ishte ai.

15 PY. Nuk bëra këtë pyetje. Pyetja është kjo që: Ju e keni
16 përmendur që ajo e pa Jakup Krasniqin në televizor vetëm në
17 takimin që bëtë me Prokurorinë muajin që shkoi, apo jo. Apo
18 nuk është kështu?

19 PË. Unë e ceka tani që ajo e pa në televizor dhe pastaj më
20 tha shiko ky është ai njeriu që ka mbajtur shënim të dhënat
21 tona.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Z. Dëshmitar, shoh orën. Ky është
23 momenti.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
25 tani pushimin e paradites.

1 Dëshmitar, Asistentja e Sallës do t'ju shoqërojë të dilni
2 nga salla. Ky është pushim prej gjysëm ore.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë këtu
5 ndërprerjen e seancës deri në orën 11.30.

6 --- Pauza fillon në orën 11.01

7 --- Seanca rifillon në orën 11.31

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
9 sillni dëshmitarin në sallë.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Thjesht për t'ju informuar sa i
11 takon kundërpyetjeve, unë mendoj që do ta kem shumë të
12 shkurtër kohën për të bërë kundërpyetjet.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 [Anëtarët e Trupit Gjykues dhe Sekretarja e
15 Gjykatës këshillohen]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Krasniqi
17 nuk është në ekran.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Krasniqi
20 ose duhet të jetë i pranishëm, ose të bëjë kërkesë për të mos
21 qenë i pranishëm.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Po nuk kemi marrë asnjë lajm. Nuk e
23 di pse nuk është. Edhe nuk mund të filloj pa qenë z. Krasniqi
24 i pranishëm.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk do të

1 fillojmë.

2 Në rregull. Ka ardhur z. Krasniqi.

3 Mund të vazhdoni, z. Ellis.

4 Z. ELLIS: [Mikrofoni çaktivizuar]

5 [Përkthim] Ndjesë.

6 PY. Dëshmitar, ju e dini që dhe mamaja juaj ka dhënë

7 deklaratë për agjenci dhe organizata të ndryshme, apo jo?

8 PË. Po.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju lutem të vendoset në ekran
10 materiali me numër U000-5328. Të gjithë dokumentet që do të
11 shfaqen nuk janë për publikun. Ndërsa serbishtja mban numrin
12 U000-5440 [Sipas përkthimit].

13 PY. Dëshmitar, mamaja juaj ka folur me policinë serbe në 31
14 shtator të vitit 1998, apo jo?

15 PË. Ka të ngjarë që po.

16 PY. E shoh -- ju kërkoj ndjesë, ju ndërpreva fjalinë më
17 duket.

18 PË. Jo, jo. Nuk ka gjë.

19 PY. Kjo ka ndodhur shkurtimisht pas momentit që mamaja juaj
20 ka parë Jakup Krasniqin në televizor në gusht ose shtator të
21 1998, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Dëshmitar, deklaratën e ke përpara në serbisht. Këtu nuk
24 përmendet fare Jakup Krasniqi, pra në deklaratë nuk përmendet
25 fare Jakup Krasniqi, deklaratën që, për policinë serbe më 31

1 shtator të 1998.

2 PË. E shoh.

3 PY. Deklarata tjetër që ka dhënë ka qenë deklaratë për OSBE-
4 në në janar të 1999.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Është një deklaratë që mban numrin e
6 provës materiale P00235. Lutem që të shfaqet kjo në ekran. Një
7 çast sepse mendoj që nuk është faqja e duhur. Na nevojitet
8 faqja 40010577.

9 PY. Është deklaratë që është dhënë për OSBE-në në janar të
10 1999. Është vetëm në anglisht, por sidoqoftë po ju them që as
11 në këtë deklaratë nuk përmendet fare emri i Jakup Krasniqit.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Vazhdojmë me dokumentin
13 SPOE00195761, në anglisht, dhe U000-0211, në serbisht.

14 PY. Mamaja juaj i ka dhënë deklaratë gjyqtarit hetues në
15 Beograd në qershor të 2000, apo jo?

16 PË. Kështu thuhet.

17 PY. Dëshmitar, unë e lexova dhe këtë deklaratë. As në këtë
18 deklaratë nuk përmendet fare Jakup Krasniqi. Pamë dhe
19 deklaratën që është dhënë për TPNJ-në në dhjetor 2000, që ka
20 qenë numër, ka pas numrin K0195141.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Do lutesha të shfaqej në ekran tek
22 faqja e tretë kjo deklaratë.

23 PY. Ju lexova paragrafin pak më përpara para pushimit dhe ju
24 kujtohet që përmendet Jakup Krasniqi. Mamaja juaj thotë që ka
25 parë një person me emrin Jakup Krasniqi, por ama këtu nuk

1 thuhet që e ka parë në televizor në gusht ose shtator të 1998,
2 apo jo, Dëshmitar?

3 PË. Mbase kështu është shkruar, unë s'lexoj në anglisht. Mund
4 të shoh, vetëm emrin dalloj të shkruar.

5 PY. Në rregull.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim dokumentin SITF000264540
7 [Sipas përkthimit], ndërsa serbishtja mban numrin SITF0062540.
8 Ju kërktoj ndjesë, anglishtja përfundon me ET në fund.

9 PY. Duhet të shfaqet dhe serbishtja në të djathtë të ekranit.

10 PË. Po, e shoh.

11 PY. Mamaja juaj ka shkuar në Agjencinë për Siguri dhe
12 Informacion, serbe, në Beograd në shkurt të 2003 për të bërë
13 një raport, kështu? Për ta raportuar si rast.

14 PË. Mbase, kështu thuhet.

15 PY. Dhe sërish, Dëshmitar, unë po ju them që as në këtë
16 deklaratë nuk përmendet Jakup Krasniqi.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim dokumentin tjetër.
18 SPOE00194062. Dhe serbishtja SPOE00062645. Në anglisht është
19 faqja 094177 [Sipas përkthimit], faqja 15 në serbisht.

20 PY. Po ju jap një çast që të lexoni përgjigjet në versionin
21 serbisht në fund të faqes, tek pika 104. Dhe 107, 108, tek
22 faqja tjetër në serbisht. Në krye të faqes.

23 Në këtë deklaratë nuk thuhet që është parë Jakup Krasniqi
24 në televizor, apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Po, nuk thuhet që "E kam parë në televizor".

1 PY. Dhe në fakt, përgjigjja te 108, për pyetjen tek pika 108,
2 përgjigjja që ka dhënë mamaja juaj është.

3 "As nuk e kam idenë kush është. E dëgjova emrin e tij në
4 korridor kur e përmendën. Dhe asgjë më shumë."

5 Kështu ka thënë mamaja juaj, apo jo?

6 PË. Po, kështu shkruhet këtu: "Nga ta di, nga ta di unë? S'e
7 kam idenë se kush është."

8 PY. Ju tregova gjashtë deklaratat e mamasë suaj nga periudha
9 e 1998, deri në 2006, Dëshmitar. Dhe në asnjë nga deklaratat
10 nuk ka thënë mamaja juaj që e ka parë Jakup Krasniqin në
11 televizor, kështu?

12 PË. Kështu.

13 PY. Nëse do e kishte parë në televizor në 1998, siç thoni ju,
14 ajo do ta kishte përmendur në një nga këto deklaratat, apo jo?

15 PË. Ka të ngjarë që po. Por ama është thënë, është shënuar që
16 ka qenë i pranishëm në Malishevë.

17 PY. Do flasim dhe për këtë. Ju keni thënë disa herë sot
18 paradite që mamaja ju ka thënë ju që Jakup Krasniqi u
19 prezantua, ose të paktën personi që ajo mendonte se ishte
20 Jakup Krasniqi ishte prezantuar. A ju kujtohet që e thatë
21 këtë?

22 PË. Po, e kam thënë. U prezantua personalisht. Tha "Quhem
23 Jakup Krasniqi." Edhe i pyeti edhe ata për emrat.

24 PY. Do lutesha të shkonim te përgjigjja e pyetjes 104 në këtë
25 faqe. Këtu nuk thuhet gjë që, nuk thuhet që një person është

1 prezantuar si Jakup Krasniqi. Por mamaja juaj ka thënë, i
2 dëgjova kur bisedonin në korridor: Ja ku po vjen personi, ky
3 person rigoroz: Jakup Krasniqi..."

4 A e shihni këtë, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të vendosni dhe një herë në
7 ekran, ju lutem, deklaratën e TPNJ-së me numër K19104 [Sipas
8 përkthimit].

9 PY. Do t'jua lexoj, Dëshmitar. Jua lexova dhe më përpara, do
10 e lexoj dhe një herë meqë nuk e kemi në serbisht.

11 Këtë ka thënë mamaja juaj për hetuesin e TPNJ-së.

12 "Në të njëjtën ndërtesë pashë një person që quhej Jakup
13 Krasniqi, që erdhi një herë në dhomën ku na mbanin. Nuk na e
14 tregoi emrin, por më vonë dëgjova shqiptarë të tjerë në
15 ndërtesë që e thirrën me emër."

16 Pra, Dëshmitar, ju më herët thatë që nuk besonit se e
17 kishit parë më përpara këtë deklaratë. Por ajo që ka thënë
18 mamaja juaj për TPNJ-në dhe UNMIK-un është që emrin e Jakup
19 Krasniqit e ka dëgjuar nga shqiptarët e tjerë në ndërtesë, jo
20 se ai u prezantua vetë. A është kështu? Këtë po shohim këtu,
21 apo jo?

22 PË. Po ju them çfarë më ka thënë mamaja. Unë s'kam qenë i
23 pranishëm. Mamaja më tha që ai i pyeti si i kishin emrat dhe
24 se u prezantua. Unë s'e di çfarë është zbardhur këtu.

25 PY. Por, ajo që po thoni ju është e ndryshme nga ajo që është

1 hedhur këtu. Është e ndryshme nga ajo që u ka thënë hetuesve,
2 apo jo?

3 PË. Jakup Krasniqi përmendet gjithandej. Tani unë s'e di si e
4 qysh...

5 PY. Dëshmitar, ju thoni që mamaja ju ka thënë ju se ai u
6 prezantua. Në deklaratën që sapo ju lexova ajo ka thënë që:

7 "Nuk na e tregoi emrin".

8 A e pranoni që kjo është e ndryshme, janë dy gjëra të
9 ndryshme?

10 PË. Unë po ju them çfarë më ka thënë mamaja. Unë s'e shpika.
11 Ajo më tha që ai personalisht u prezantua dhe tha që quhej
12 Jakup Krasniqi dhe i pyeti dhe ata si i kishin emrat.

13 PY. Por ama nuk ia ka thënë këtë hetuesve?

14 Z. BAARLINK: [Përkthim] Kjo pyetje është bërë dhe ka
15 marrë përgjigje.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt është
17 trajtuar disa herë tani.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Në rregull, do të vazhdoj më tej.

19 PY. Dëshmitar, në fillim të dëshmisë suaj folëm për
20 strukturën e UÇK-së në Rahovec dhe ju nuk e dinit, por ju nuk
21 e dinit çfarë strukture kishte UÇK-ja në Malishevë në korrik
22 të 1998, apo jo?

23 PË. Jo, nuk e dija. Nuk e dija as për Malishevën as për
24 Rahovecin sepse çdo gjë ndodhi shumë shpejt.

25 PY. Por ju besoj e dini që në zonën e Malishevës ka shumë

1 persona me mbiemrin Krasniqi?

2 PË. Po, ka mundësi që po.

3 PY. Në fakt Krasniqi është një nga mbiemrat më të përdorur,
4 më të përhapur në Kosovë, apo jo?

5 PË. Nuk e di. Por është e sigurt që ka shumë me këtë mbiemër.

6 PY. A e dini ju që ndonjëherë Gani Krasniqit i drejtoheshin
7 si kryebashkiaku i zonës së lirë në Malishevë në korrik të
8 1998? Apo komunali i zonës së lirë në Malishevë në --

9 PË. Kjo është hera e parë që e dëgjoj këtë për Gani
10 Krasniqin. Por unë s'po them që s'ka persona të tjerë me
11 mbiemër Krasniqi. Me siguri që ka. Gani Krasniqin s'e kam
12 dëgjuar ndonjëherë.

13 PY. E kuptoj.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Referenca e radhës nuk është për
15 publikun, por -- nuk është për dëshmitarin, por është për
16 personat që na ndjekin në sallën e gjyqit. [REDAKTUAR]
17 [REDAKTUAR].

18 PY. Dëshmitar, Jakup Hoti, personi që mamaja juaj identifikoi
19 si një nga personat që ka qenë në stacionin e policisë në
20 Malishevë [REDAKTUAR]. Dhe në
21 deklaratë e kanë pyetur kujt i raportonte. Ai është
22 përgjigjur:

23 "Në atë kohë, shtabi përbëhej nga Ganiu, Hysniu dhe
24 Skënder Krasniqi."

25 A e dini ju që Gani Krasniqi dhe Skënder Krasniqi ishin

1 pjesë e shtabit të Malishevës në korrik të 1998?

2 PË. Jo, nuk e dija këtë.

3 PY. Ju konfirmuat që punoni për [REDAKTUAR].

4 Ju e dini që dhe shteti serb i ka hetuar ngjarjet e korrikut
5 të 1998, apo jo? Ka kryer hetime.

6 PË. Kanë kryer hetime, por unë s'kam asnjë informatë në
7 lidhje me këtë. Unë thjesht po ju them ngjarjen se si ma ka
8 treguar mamaja dhe jo të bazuar në hetimet që ka kryer
9 [REDAKTUAR].

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë, do t'ju tregoj dokumentin
11 SITF00304479.

12 PY. Kjo është një shkresë që është dërguar nga Ministria e
13 Punëve të Brendshme në -- qershor të 2005, drejtuar UNMIK-ut.
14 Shkojmë pak më poshtë, e kuptoj që ju nuk lexoni anglisht, por
15 poshtë është një listë që ka emrat e personave që autoritetet
16 serbe besonin se ishin të përfshirë në rrëmbimin e civilëve
17 serbë në Rahovec.

18 Dhe mund të shikoni, 1, 3, 4, 5.

19 PË. E shoh, po.

20 PY. Në listë tek 3, shohim Skënder Krasniqin, 5, Jakup Hoti.
21 Në dokument nuk përmendet fare Jakup Krasniqi, apo jo?

22 PË. Kështu thuhet. Agron Berisha, Skënder Krasniqi, Hysni
23 Kilaj, Jakup Hoti dhe Ragip Thaçi.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë në dokumentin SITF00 [Sipas
25 përkthimit] -- i cili nuk duhet të transmetohet për publikun.

1 PY. Ky është një dokument tjetër i Ministrisë së Punëve të
2 Brendshme Serbe në shkurt të 2004. Shkojmë në fund të faqes,
3 vetëm për të konfirmuar emrin -- ky është emri i mamasë suaj
4 apo jo? Thjesht për të konfirmuar emrin.

5 PË. Po, por ky nuk është dokument i Ministrisë së Brendshme.

6 PY. Personi që përmendet këtu si i dyshuar është Skënder
7 Krasniqi. Mund ta shihni emrin tek rreshti i parë fare, tek
8 paragrafi i parë në ekran.

9 PË. E shoh, por kjo nuk është deklaratë e mamasë sime. Kjo
10 është një deklaratë që ka lidhje me fshatin Retijë.

11 PY. Në rregull.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin.

13 PY. Dhe vazhdojmë tek një aspekt tjetër. Ju thatë se keni
14 marrë pjesë bashkë me mamanë për intervistën, tek intervista e
15 UNMIK-ut. S'e mbaj mend datën. A ju kujtohet se mamasë suaj i
16 treguan disa fotografi dhe i kërkuan të identifikonte personat
17 në të?

18 PË. S'jam i sigurt. Mbase po. Por nuk ma merr mendja se do të
19 kishte njohur ndonjë prej tyre.

20 PY. Në rregull. E shohim.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Të shfaqim në ekran dokumentin

22 SPOE00194018. Faqja e parë është 194022.

23 PY. Dëshmitar, kjo është lista e fotografive që i kanë
24 treguar mamasë suaj. Mund të shihni këtu emrin Jakup Krasniqi
25 dhe ka numrat 5, 7 dhe 14 përbri, kështu?

1 PË. Po, këto janë 5, 7, 14, Jakup Krasniqi.

2 PY. Shohim përgjigjen që ka dhënë mamaja juaj kur i kanë
3 treguar këto fotografi.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Është dokumenti me numër
5 SPOE00194062 në anglisht dhe SITF00062645 në serbisht. Fillon
6 tek faqja 194081 dhe 62664 në shqip [Sipas përkthimit].

7 PY. Shohim këtu te pika 136, i kanë treguar fotografinë numër
8 5 mamasë dhe ajo është përgjigjur:

9 "Nuk e di."

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë më poshtë, 138 në të njëjtin
11 ekran.

12 PY. Prapë i kanë treguar fotografinë numër 7, përgjigjet:

13 "Nuk e di emrin, nuk di asgjë."

14 Pastaj tek pyetja 147, që duhet të jetë në faqen e
15 radhës, i treguan fotografinë numër 14 dhe u përgjigj:

16 "Asgjë..."

17 Domethënë, Dëshmitar, është e qartë se nënës tuaj iu
18 treguan tre fotografi të Jakup Krasniqit dhe ajo nuk e
19 identifikoi atë në asnjërën prej këtyne fotografive.

20 PË. Ashtu shkruan. Tani unë vetë nuk kam qenë aty. Nuk kam si
21 ta di.

22 PY. Por e shikoni se kështu thuhet në këtë dokument,
23 Dëshmitar, apo jo?

24 PË. Po, ashtu shkruan.

25 PY. Sikur ta kishte parë Jakup Krasniqin në qershor -- në

1 korrik të 1998 dhe ta kishte njohur në televizion në gusht,
2 apo shtator të 1998, ajo sigurisht do ta kishte njohur edhe në
3 këto tre fotografi që ju treguan, apo jo?

4 PË. Besoj që po, por unë ua thashë që ma tha nëna, se ky
5 ishte personi, unë nuk e shpifa as emrin as mbiemrin, as nuk e
6 kam njoftë këtë njeri.

7 PY. Por dihej publikisht në korrik të 1998 se Jakup Krasniqi
8 ishte zëdhënësi i UÇK-së, a e keni ditë ju vetë këtë?

9 PË. Nuk e kam ditë.

10 PY. Por sikur thatë më herët që ky person ishte çdo herë,
11 dilte çdo herë në televizion, nuk e keni ditë se ka qenë
12 zëdhënësi i UÇK-së?

13 PË. Nuk e kam ditë që ishte zëdhënësi i UÇK-së. E kam ditë
14 thjesht që është në UÇK edhe pas gushtit apo shtatorit të 1998
15 ai dilte shpesh në televizor.

16 PY. Tani e shikoni nga dokumentet, por nuk e keni ditë vetë
17 më herët, se të paktën dy anëtarë të tjerë të shtabit të UÇK-
18 së Malishevë ishin me mbiemrin Krasniqi, Gani Krasniqi dhe
19 Skënder Krasniqi. E shikoni këtë në dokument, apo jo?

20 PË. Nga ajo që arrita të lexoj në këtë dokument Skënder
21 Krasniqi përmendet në lidhje me disa fshatra rreth Rahovecit,
22 ku rrëmbyen rreth 20 njerëz, fshatrat si Opterusha, Retija dhe
23 fshatra të tjera.

24 PY. Unë po jua them qartë, z. Dëshmitar, se Jakup Krasniqi
25 nuk është taku me nënën tuaj në stacionin e policisë në

1 Malishevë në korrik të 1998 dhe se ju vetë në atë kohë nuk
2 keni qenë në pozitë që të konfirmoni se nëna juaj e kishte
3 parë atë.

4 PË. Unë konfirmoj se nëna ime ma ka thënë që emri i tij ishte
5 Jakup Krasniqi. Ajo më tha që emri dhe mbiemri i tij ishte
6 Jakup Krasniqi. Nuk më dha hollësi të tjera, por mund t'ju
7 konfirmoj 100 për qind se këtë ma ka thënë ajo, unë nuk i kam
8 nxjerrë nga mendja këto informacione.

9 Tani në qoftë se ai me të vërtetë ka qenë Jakup Krasniqi
10 apo jo, këtë nuk mund ta konfirmoj.

11 PY. Pikërisht kështu, ju kujtohet që këtë ua ka thënë nëna,
12 por ju vetë nuk mund ta konfirmoni këtë, apo jo?

13 PË. Unë vetë nuk kam pasur njohuri personale sepse unë vetë
14 nuk kam qenë atje. Siç ju thashë më herët, asnjë burrë nuk ka
15 shpëtuar i gjallë nga ai rast. Të gjithë u vranë.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera, ju
17 faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. Misetic, urdhëroni.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

21 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

22 Z. MISETIC: [Përkthim]

23 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar. Unë jam Luka Misetic. Jam Avokati
24 i z. Thaçi dhe kam disa pyetje për ju sot mbasdite.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë, i nderuar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjkata Themelore

Dëshmitari: W00498 (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 60

1 Gjykatës, shkurtimisht në seancë private për të mbrojtur
2 identitetin e dëshmitarit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
4 seancë private, znj. Sekretare.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të
15 hapur.

16 Z. MISETIC: [Përkthim]

17 PY. Dëshmitar, më 17 korrik 1998, ju vetë keni qenë në
18 Rahovec, pra atë ditë?

19 PË. E saktë. Kam qenë në vendin e punës deri në orën 15.00.

20 PY. Në rregull. Dhe kur keni përfundu orarin e punës, çfarë
21 keni bërë?

22 PË. Shkova në shtëpi, hëngra bukë dhe pastaj shkova për të
23 lujtë futboll.

24 PY. Dhe sipas deklaratës shkua për të lujtë futboll nga ora
25 17.00, a është kjo e saktë?

1 PË. Po, e saktë.

2 PY. Ku saktësisht në qytet keni lujtë futboll?

3 PË. Në qendrën sportive të Rahovecit, në qoftë se e dini se
4 ku gjendet.

5 PY. Mund të më ndihmoni për ta kuptu se ku gjendet. A është
6 në qendër të qytetit?

7 PË. Është dikund afër tregut. Afër firmës apo kompanisë
8 Orbit.

9 PY. Po i bie kjo të jetë në qendër të qytetit?

10 PË. Nuk është mu qendra e qytetit, por është afër qendrës.

11 Është një pjesë ku kryesisht jetojnë shqiptarë.

12 PY. Në deklaratë thoni se dolët nga shtëpia dikund rreth orës
13 18.00. A është kjo e saktë?

14 PË. Nuk e di në qoftë se ka qenë saktësisht në orën 18.00,
15 por dolëm nga shtëpia kur na nxori policia.

16 PY. Dhe përveç që keni thënë se policia ju tha që të dilnit,
17 ju vetë nuk, në deklaratë thoni që nuk patë ndonjë gjë të
18 çuditshme apo të pazakontë atë ditë në qytet.

19 PË. Nuk kishte asnjë gjë të pazakontë. Ishte një ditë e
20 thjeshtë, sikurse çdo ditë tjetër.

21 PY. Dhe asnjë gjë s'ju duk e pazakontë, derisa shkuat në
22 shtëpi. A është kjo e saktë?

23 PË. Po. Ne po luanim futboll dhe atëherë dëgjumë edhe të
24 shtëna. Nuk dinim se prej nga vinin këto të shtëna.

25 PY. Ju thatë edhe një herë që nuk patë asnjë gjë të pazakontë

1 kur dolët nga shtëpia. A është kjo e saktë?

2 PË. Asgjë të pazakontë, thjesht kishte njëfarë lëvizje,
3 njëfarë tubim njerëzish, banorësh shqiptarë në një rrugë. Ne
4 vetë ishim me veturë.

5 PY. Dëshmitar, nëna juaj asnjëherë më nuk e pa vëllanë pas
6 natës së 17 korrikut 1998, a është kjo e saktë?

7 PË. Po, e saktë. Nuk e ka pa më as vëllaun as babanë. Dhe nuk
8 ka qenë natë, por ka qenë dikund rreth orës 16.00 apo 17.00 në
9 hymje të Rahovecit.

10 PY. Po dikush tjetër nga familja juaj, a e ka parë vëllaun
11 mbas datës 17 korrik 1998?

12 PË. Jo.

13 PY. A e dini, a keni dijeni që gruaja e vëllaut dhe tezja apo
14 halla, kanë pretenduar që e kanë parë vëllanë në dy raste të
15 tjera pas 17 korrikut 1998?

16 PË. Nuk ka se si ta kenë parë sepse ato ishin në Beograd. Dhe
17 kishin dëgju një mesazh në telefon. Dikush kishte marrë në
18 telefon dhe ishte prezantu si [REDAKTUAR].

19 PY. Dhe a keni dijeni që dikush faktikisht ka thënë, ka pohu,
20 që e ka pa vëllanë tuaj duke vozitur makinën në Prizren në
21 dhjetor të 1998?

22 PË. Kjo nuk është e vërtetë. Dikush ka thënë thjesht që e ka
23 parë, apo që i është duk se e ka parë, por kjo nuk është e
24 vërtetë.

25 PY. Po e a dini që faktikisht kunata juaj, gruaja e vëllaut,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W00498 (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 64

1 e ka thënë këtë, që e ka pa vëllanë në dhjetor të 1998 në

2 Rahovec?

3 PË. Jo, nuk e ka parë dhe kjo që thoni nuk është e vërtetë.

4 PY. Po të paktën, a e dini që kjo e ka thënë këtë gjë, gruaja

5 e vëllaut?

6 PË. Nuk e ka thënë. 100 për qind nuk e ka thënë. Sepse ata

7 janë vrarë pesë ditë pas shkuarjes nga Malisheva. Kështu jemi

8 informuar ne.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të vendosim në
10 ekran dokumentin me numër SPOE00401751 [Sipas përkthimit] deri
11 759 [Sipas përkthimit]. Këto janë faqe brenda dokumentit
12 SPOE00116985.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mund ta përsëritni
14 numrin ERN?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] SPOE40010571 deri në SPOE40010579.
16 Brenda dokumentit SPOE00116985. Në këtë dokument duhet të jetë
17 576.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Sa për procesverbalin
19 është provë materiale P00235.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Nëse mund të kalojmë
21 tek paragrafi 15, ju lutem.

22 PY. Dëshmitar, kjo është deklarata e kunatës, e gruas së
23 vëllaut. Do t'ua lexoj në mënyrë që t'ju përkthehet. Ajo u tha
24 hetuesve si vijon:

25 "Për më tepër, jam e bindur që e kam parë burrin në

1 Rahovec para një jave nga dita e sotme më 21 dhjetor 1998.
2 Kishte një Fica plot me shqiptarë mbas një veture Lada me
3 rreth 7 njerëz aty. Vetura nuk kishte targa të regjistrimit,
4 burri im ishte në Lada. Vetura po lëvizte ngadalë. Nuk [Sipas
5 përkthimit] jam e sigurt për këtë.

6 A nuk ua ka përmend asnjëherë kunata këtë, nuk ju ka
7 thënë që kështu ka deklaruar?

8 PË. Jo, nuk ma ka përmend. Unë për herë të parë e dëgjoj këtë
9 gjë.

10 PY. Në rregull.

11 PË. Nuk e di se si ka mund ta shohë vëllanë kur ata janë
12 vrarë menjëherë në gusht në Malishevë? Cila ishte data e kësaj
13 deklarate? Cili vit?

14 PY. Siç shihet nga deklarata që është janari i 1999. Aty flet
15 për momentin kur e ka parë "një javë përpara" ditës kur jep
16 deklaratën, pra në 1999. Kemi dhe një deklaratë tjetër ku nëna
17 juaj thotë që kunata juaj dhe e reja e saj i ka thënë këtë
18 gjë. Nëna juaj s'jua ka përmend juve këtë pjesë të dëshmisë
19 asnjëherë.

20 PË. S'e kam dëgju kurrë më parë këtë gjë. Kjo është hera e
21 parë.

22 PY. Ju thatë që xhaxhai ju ka thënë që vëllai juaj ka lënë
23 mesazh tek, në telefon, tek sekretaria një javë pasi është
24 largu.

25 PË. Saktë, kështu është. Nuk e di tani a ka qenë vëllai ai që

1 e ka lënë këtë mesazh. Xhaxhai im e ka marrë kasetën bashkë me
2 regjistrimin për analizë, por përfundimisht nuk kanë arritur
3 të vërtetojnë asgjë.

4 PY. Ku e ka dërgu këtë kasetë?

5 PË. Në polici në Beograd.

6 PY. Me sa dini ju, a ka policia një kopje të kësaj kasete?

7 PË. Tani pyetja është, a ekziston akoma apo jo. E di që
8 xhaxhai im e ka çu atje. Tani ku, në cilin vend e ka dërgu, e
9 di që ka qenë, e ka dërgu policisë në Beograd.

10 PY. A jeni në dijeni që nëna jote ka dëshmuar që vëllai juaj
11 ka lënë mesazh tek shtëpia e kunatës tënde në fund të
12 shtatorit 1999?

13 PË. Kunata ka jetu me mu për tre-katër muaj pas ngjarjes, me
14 nënën time. Pas kësaj periudhe, ajo është larguar dhe s'e kemi
15 parë më. Nuk ka jetu vetëm. Dhe nuk ka mundësi të ketë thënë
16 që dikush ka lënë mesazh në shtëpinë e saj. Mesazhi është lënë
17 në telefonin e hallës dhe xhaxhait në Beograd. Dhe në mesazh
18 thuhet "Jam [REDAKTUAR]" dhe kaq.

19 PY. Në rregull. Tani po ju tregoj deklaratën e nënës tuaj.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] SPOE00195761 deri tek 00195763
21 RED2, faqja 3, e cila nuk duhet të shfaqet për publikun, ju
22 lutem.

23 Z. Gjykatës, më duhet të lexoj disa emra dhe për
24 rrjedhojë do kërkoja të kalojmë shkurtimisht në seancë
25 private.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

2 Sekretare, na kaloni në seancë private, ju lutem.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

24 jemi në seancë publike.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

1 PY. Dëshmitar, dua t'ju tregoj një deklaratë që ka dhënë nëna
2 juaj në qershor të 2006, UNMIK-ut.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Deklarata është SPOE00194062 deri
4 në 00194084 RED3. Dhe ky dokument nuk duhet të shfaqet për
5 publikun. Nëse mund të kalojmë në faqen 00194079, ju lutem. Në
6 qoftë se mund të shohim më poshtë, tek pjesa ku fillon "Nga
7 prilli viti i kaluar...", këtu jemi.

8 PY. Kjo është diçka që nëna juaj ka deklaruar në qershor të
9 2006 dhe duhet t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë. Ajo thotë:

10 "Nga prilli vitin e kaluar jam grua e sëmurë dhe nuk
11 shkoj më askund sepse fëmijët e mi nuk më lejojnë ta bëj këtë
12 gjë. Ata më thonë: 'Do të rrish këtu, je e sëmurë dhe nuk do
13 t'i mbijetosh kësaj!' Por unë nuk doja të mos jem këtu dhe për
14 këtë arsye erdha. Dhe kjo më prek, jam e shqetësuar."

15 Tani në qershor të 2006 nëna juaj deklaroi se në prill të
16 vitit "paraprak", që i bie të jetë viti 2005, ishte sëmurë. A
17 mund të na thonë për çfarë sëmundje e kishte fjalën? Ajo shton
18 dhe thotë, fëmijët, besoj që jeni edhe juve, nuk e lejojnë atë
19 që të shkonte askund për shkak të sëmundjes së saj. Nga çfarë
20 sëmundje vuante nëna juaj në prill 2005?

21 PË. Kishte sëmundje të ndryshme. Ka qenë sëmurë që kur ka
22 qenë e re. Ka lindur në vitin 1945. Ka vdekur 61 vjeçe. Ka
23 patur probleme tensioni të lartë, niveli i sheqerit në gjak i
24 lartë, e shumë gjëra të tjera. Dhe nuk e kam lejuar që të
25 shkoj askund, te këto organizata apo tjetër, sepse nuk do të

1 arrinte asgjë. Të gjithë thonin të njëjtën gjë, gjëra të
2 ndryshme, si ndodhi, ku ndodhi, e njëjta histori gjithmonë.
3 Kur kthehej ishte edhe më keq. Ndihej edhe më keq. Dhe unë dhe
4 vëllezërit e mi nuk e kemi lejuar që të vazhdojë të bëjë këtë
5 gjë.

6 PY. Në rregull. Por ajo po, në këtë deklaratë me sa duket
7 përmend, e ka fjalën për një diagnozë konkrete, në prill të
8 2005. A ju kujtohet çfarë, për çfarë e kanë diagnostikuar në
9 prill 2005, për çfarë sëmundje?

10 PË. Më kujtohet gjithçka, si mund të mos i kujtoj. Ajo ka
11 patur tumor në gji.

12 PY. Në rregull. Dhe kjo ishte shkaku i vdekjes së saj
13 përfundimisht pastaj?

14 PË. Nuk e di arsyen e vdekjes. Ka vdekur pak nga të gjitha.
15 Të gjitha së bashku. Dhe unë nuk kam qenë përgjegjës për të
16 hetuar shkakun e vdekjes së saj.

17 PY. Në rregull.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se kalojmë tek faqja 4083
19 në të njëjtin dokument. Në pjesën ku thotë: "Mund të shtoj një
20 kërkesë..."

21 Në qoftë se mund të shohim më poshtë. Këtu kemi pjesën në
22 fjalë.

23 PY. Ajo thotë:

24 "Mund të shtoj një kërkesë që të më sillni burrin dhe
25 djalin tim gjallë dhe në shëndet të mirë. Kjo është shtesa,

1 ajo që kisha për të thënë. Nuk kërkoj asgjë më tepër. Kjo
2 është e rëndësishme për mu dhe asgjë tjetër nuk më intereson.”

3 Desha të vërtetoj që diagnoza për tumor në gji është bërë
4 përpara se të merrte vesh për konfirmimin përmes ADN-së dhe
5 zbulimit të mbetjeve mortore, saktë?

6 PË. Po.

7 PY. Faleminderit, Dëshmitar, që iu përgjigjët pyetjeve të
8 mia.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, nuk kam më pyetje.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
11 z. Misetic.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
14 Kërkoj ndjesë, ka pyetje Prokuroria?

15 Gjykatësi Barthe ka disa pyetje.

16 Gjykatësi Barthe, fjalën e keni ju.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
18 Faleminderit, Gjykatës Smith.

19 Pyetje nga Trupi Gjykses:

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

21 Mirëdita, z. Dëshmitar. Shpresoj që mund të më dëgjoni mirë.

22 PË. Po, ju dëgjoj mirë.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

24 Faleminderit. Kam vetëm disa pyetje lidhur me atë që dëshmuat
25 sot dhe atë që keni deklaruar në seancën përgatitore në

1 dhjetor vitin e kaluar me Prokurorinë. Në Shënimin përgatitor
2 2 që mban numër ERN 117822 dhe 117823, keni deklaruar që
3 familja nuk ka bërë kërkime, nuk ka pyetur [Sipas përkthimit]
4 shqiptarë, nuk ka kërkuar [Sipas përkthimit] të zbulojë lidhur
5 me rrëmbimin e babait dhe vëllait tuaj. Ka biseduar me
6 shqiptarë, por nuk ka bërë kërkesë zyrtare tek autoritetet e
7 UÇK-së lidhur me këtë. Dhe se nëna juaj ka njohur Ismet Taren
8 dhe Hajredin Cenën [Sipas përkthimit] që njihet edhe si Sosi.

9 Së pari, a ju kujtohet që ia keni thënë këtë ZPS-së vitin
10 e kaluar në dhjetor 20023?

11 PË. Po, më kujtohet.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
13 Faleminderit, Dëshmitar. Dua të di përse ju dhe nëna juaj
14 ishit të sigurt që kidnapimin e kishte kryer UÇK-ja?

15 PË. Po kush tjetër mund ta kishte bërë? I mora kufomat nga
16 Malisheva, u gjendën kufomat e tyre në 2007 falë analizës së
17 ADN-së, i mora kufomat dhe ishte e vërtetuar që ishin
18 ekzekutuar. Kështu që 100 për qind e sigurt që ka qenë UÇK-ja.
19 Askush tjetër. Kush tjetër mund ta kishte bërë?

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
21 Faleminderit. Dhe ju thatë, Dëshmitar, se nëna juaj e njohu
22 Ismet Tarën dhe Sabahudin Cenën, apo Sosin. Pyetja ime është,
23 nga i njohu ajo z. Tare dhe Z. Cena? I njihte që më përpara?

24 PË. Kështu, me të parë, po. Se unë ju thashë, Ismet Tara
25 kishte një qebaptore, ndërsa Sabahudin Cena punonte në

1 fabrikën "18 Nëntori", domethënë nuk është se ishte punëtor i
2 thjesht, ishte diçka inxhinier a diçka. Kishte diplomë
3 universiteti.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
5 Faleminderit. Mos po thoni që nëna juaj e dinte që z. Tara
6 kishte qebaptore dhe z. Cena punonte në fabrikë, me aq sa
7 dini?

8 PË. Po. Kështu është, është e vërtetë. Sabahudin Cena punonte
9 në fabrikë, siç e thashë, dhe personi tjetër ishte pronari i
10 qebaptores.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] E
12 dinte nëna juaj këtë?

13 PË. Ajo e dinte se Cena punonte në fabrikë sepse edhe babai
14 im ka punuar në të njëjtën fabrikë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
16 Faleminderit.

17 Pyetja tjetër që kam është, përse ju apo dikush tjetër
18 nga familja juaj nuk folët zyrtarisht, siç thatë ju, me
19 anëtarë të UÇK-së, mos do të thotë kjo që ndonjë anëtar i
20 familjes tuaj, me aq sa dini ju, ka folur jo zyrtarisht me
21 ndokënd nga UÇK-ja?

22 PË. Po nuk i gjenim dot, se ishin fshehur në mal.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Pra,
24 në vitin 1998? Ju thatë që ishin të fshehur nëpër pyje në 1998
25 edhe në 1999, po më vonë përse nuk folët me ta?

1 PË. Kemi provu që të flisnim me ata, por askush nuk donte të
2 na tregonte. Nuk thanë asgjë për askënd. Edhe sot e kësaj dite
3 nuk e dimë se si janë vrarë. Dhe janë, kanë qëndruar të
4 fshehur nëpër pyje në 1997 deri në 2000 kur erdhi KFOR-i.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Tani
6 do ju pyes lidhur me paragrafin tjetër në Shënimet Përgatitore
7 të ZPS-së që është paragrafi 5. Sipas këtij paragrafi,
8 Dëshmitar, ju i keni thënë Prokurorisë në dhjetor të vitit
9 2023 se familja juaj mësoi për përputhjen e ADN-së me të
10 afërmit tuaj në shkurt të 2007 dhe se nëna juaj u sëmur prej
11 kësaj dhe vdiq mbas një muaji.

12 Po kështu, Prokurorisë i keni thënë apo i keni shpjeguar
13 se familja, pra familja juaj, gjer atëherë mbante shpresë. Pra
14 gjer në shkurt të 2007, se mos babai dhe vëllai juaj ende
15 ishin gjallë dikund.

16 Dëshmitar, sot më herët ju na thatë se të gjithë flisnin
17 për këtë që babai dhe vëllai ishin ende gjallë, se mos po
18 punonin, bënë punë të detyruar diku në ndonjë kamp a ndonjë
19 minierë. Kështu që dua t'ju pyes, kush ishin këta njerëz që
20 thoshin se babai dhe vëllai juaj ishin ende gjallë dhe bënë
21 punë të detyruar dikund me ndonjë kamp apo ndonjë minierë, a
22 dikund tjetër? Kush jua ka thënë këtë?

23 PË. Këta ishin njerëz të kombësisë shqiptare me të cilët
24 punoja. Së bashku jemi jetuar, kemi kaluar kohë bashkë, kemi
25 ngrënë e kemi pirë. Këta ishin ata që thoshin se me shumë

1 gjasë ishin gjallë e me shumë gjasë punonin në një minierë a
2 dikund kështu. Këta ishin ata të cilët na kanë thënë këtë gjë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Dhe në
4 fund dua t'ju pyes si vijon. Sot na thatë se mamaja juaj ka
5 vdekur në mars të 2007. Një muaj pasi mësoi, pra, mbasi mori
6 informacionin se babai dhe vëllai juaj kishin vdekur. Kështu
7 është?

8 PË. Po, kështu është. Në vitin 2007.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Kur
10 morët në dorëzim kufomat ose rreth qershorit 2007, nëna kishte
11 vdekur tashmë, kështu?

12 PË. Po, kështu është. Unë mora në dorëzim kufomat dhe i
13 varrosa. Kam edhe akt-ekspertizën e autopsisë lidhur me
14 mënyrën e vrasjes.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Nëna
16 juaj nuk mund të merrte pjesë në varrimin e babait dhe vëllait
17 tuaj, se kishte ndërruar jetë tashmë, në mars të 2007, kështu?

18 PË. Po, kështu është. Kështu është. Ajo ka vdekur në mars,
19 unë kufomat i mora në dorëzim në qershor.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
21 Faleminderit, Dëshmitar, nuk kam pyetje të tjera.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka Prokuroria
23 pyetje mbështetur në pyetjet që ka bërë Gjykatësi Barthe?

24 Z. BAARLINK: [Përkthim] Jo.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju keni

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W00498 (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 75

1 pyetje lidhur me këto që bëri pyetje Gjykatës Barthe?

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

5 ZNJ. ROWAN: Jo.

6 Z. ROBERTS: Jo.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
8 këtu ka përfunduar dëshmia juaj, do t'ju shoqërojnë të dilni
9 nga kjo sallë dhe nuk ju mbajmë më këtu. Faleminderit për
10 informacionet që na i dhatë. Ju urojmë gjithë të mirat.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Ju falënderoj edhe unë juve.

12 [Dëshmitari largohet]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Ellis.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Kërkoj ndjesë se harrova që të
15 paraqes provat për t'u pranuar.

16 I pari është me numër SPOE00201838, që është dokumenti me
17 titullin "Lista e armëve Rahovec".

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
19 kundërshtim Prokuroria?

20 Z. BAARLINK: [Përkthim] Jo.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 201838 do të
22 pranohet në provat gjyqësore, do t'i caktohet një numër.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe tjetër --

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prisni pak,
25 ju lutem.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
2 SPOE00201838 deri në SPOE00201859 do të marrë numrin e provës
3 materiale 4D26.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe dy ishin dokumentet në serbisht.

6 i pari është me numër SITF00304479 dhe i dyti është me numër

7 SITF0030270, nëse po e lexoj mirë shkrimin tim të dorës. Do

8 t'i kontrolloj dhe një herë. Po, besoj se këto janë numrat.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
10 kundërshtim nga Prokuroria?

11 Z. BAARLINK: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
13 çaktivizuar]

14 SITF00304479 dhe 00304482 pranohen në prova gjyqësore.

15 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
17 dokumenti me numër ERN SITF00304479 deri në 00304482 do të
18 marrë numrin e provës materiale 4D27 dhe sa i takon dokumentit
19 tjetër SITF00300270 dhe 00300271 do të marrë numrin e provës
20 materiale 4D28.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. BAARLINK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kemi nevojë
23 për pesë minuta kohë që të bëjmë ndërrimin e ekipit për
24 dëshmitarin tjetër. Ndërkohë po i afrohem pushimit të drekës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të

1 fillojmë këtu pushimin e drekës, do të rikthehemi në orën
2 14.30, në mënyrë që të mos punojmë shumë pak.

3 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.42

4 --- Seanca rifillon në orën 14.30

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të vijoj
6 me dëshminë e dëshmitarit të Prokurorisë me numër 04576.

7 Përpara se të vijë dëshmitari Trupi Gjykues vëren që
8 Mbrojtja e Thaçit ka bërë njoftim për Trupin Gjykues lidhur me
9 një kundërshtim që mund të kenë, për një përdorim nga ana e
10 ZPS-së të një libri që ka botuar dëshmitari 04576.

11 Z. Misetiç, vazhdoni t'i qëndroni kësaj?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Në varësi të mënyrës se si do
13 t'i drejtojë pyetjet Prokuroria, po, kundërshtimi qëndron.
14 Keni nevojë për argumentim të mëtejshëm?

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
16 çaktivizuar]

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne mendojmë që dëshmitarit duhet
18 t'i bërë pyetje fillimisht, çfarë di. Ai është këtu, të japë
19 dëshmi dhe jo t'i japin librin përpara dhe ai të fillojë të
20 lexojë librin dhe t'i bëjmë pyetje, të konfirmojë ato që ka
21 thënë në libër.

22 Nëse ka dëshmitari nevojë t'i rifreskohet kujtesa ka një
23 procedurë që ndiqet në bazë të rregullës 142, pika 1, dhe për
24 këtë duhet marrë leja e Trupit Gjykues.

25 Qëndrimi ynë është po ashtu në bazë të vendimit të Trupit

1 Gjykues, në bazë të rregullës 143, nga java e shkuar, dhe ne
2 mendojmë që libri nuk është një deklaratë në vetvete dhe nuk
3 mund të pranohet për vërtetësinë e përmbajtjeve.

4 Me fjalë të tjera, nëse dëshmitari thotë, "Unë them A",
5 por në libër është thënë "B"-ja, Trupi Gjykues nuk mund të
6 marrë parasysh pjesën B. Dhe Prokuroria atëherë duhet mos e
7 marrë fare parasysh dëshminë. Por Prokuroria nuk mund të thotë
8 që ne do marrim parasysh atë që është thënë në libër, në qoftë
9 se dëshmitari thotë diçka që është në kontradiktë.

10 Nëse rregulla 143 është *lex specialis* për atë që mund të
11 bëjë pala është kundërshtimi që mund të bëjmë ne për
12 besueshmërinë e dëshmitarit.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, a keni burime
14 ju që mund t'i përdorni si bazë apo burime ligjore që ne nuk
15 duhet të mbështetemi në një provë materiale që tashmë është
16 pranuar sipas rregullës 138(1) sa i takon vërtetësisë së
17 përmbajtjes?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse doni burime ligjore do më
19 duhet t'i kërkoj fillimisht, sepse kjo është një situatë
20 unike. Por po ju them që ky është një dallim opinionesh.
21 Varet, pra, se si e interpreton Trupi Gjykues rregullën 143(c)
22 [Sipas përkthimit] dhe si e interpretojmë ne. Sipas
23 interpretimit tonë libri është një deklaratë e mëparshme
24 inkonsistente dhe besojmë se për këtë pajtohet edhe ZPS-ja.

25 Por fillimisht të kemi parasysh që rregulla është *lex*

1 *specialis* për mënyrën se si një palë mund të diskreditojë ose
2 të kundërshtojë besueshmërinë e dëshmitarit të vet. Përveç
3 kësaj, nuk ka pse, nuk ka pse të gjejmë ne burime ligjore kur
4 një dëshmitar thotë diçka që është në kontradiktë, është
5 kontradiktore [Sipas përkthimit].

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por a nuk do të ishte e
7 njëjta gjë, për shembull, në qoftë se kemi një, për shembull,
8 do ta them ndryshe; do t'jua bëj më të qartë. A nuk është, në
9 qoftë se libri kërkohet që të pranohet si provë a nuk mund të
10 pranohet ky libër sipas rregullës 138(1), dhe jo 143(2) [Sipas
11 përkthimit] sepse sikurse ju thatë nuk mund të kualifikohet si
12 deklaratë, sepse nuk është marrë në kuadër të këtij procesi
13 gjyqësor?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Një urdhër është një dokumenti i
15 kohës përkatëse që është përgatitur përgjatë zhvillimeve të
16 një procesi të caktuar; një libër që është shkruar
17 pesëmbëdhjetë vite pas faktit nuk është një dokument i një
18 ngjarje të një kohe të caktuar. Pra, sipas nesh kjo është një
19 deklaratë dhe për këtë e ka marrë një urdhër Trupi Gjykses
20 ditën e premte dhe besoj se dhe ZPS-ja dhe Mbrojtja e Thaçit
21 jemi pajtuar për këtë dhe ne mendojmë që kjo është një
22 deklaratë që duhet paraqitur sipas rregullës 143(2)(c).

23 Por tani Trupi Gjykses ka marrë vendim që deklarata për
24 këtë rregull duhet të interpretohet në përputhje me
25 përkufizimin e rregullës 153 deri në 155. Pra, që gjithçka të

1 zbatohet në mënyrë të barabartë. Tani unë mendoj që vetëm disa
2 pjesë të deklaratës janë të pranueshme sipas rregullës 143 dhe
3 janë vetëm ato deklarata që janë në përputhje me rregullën 153
4 deri në 155. Por për një libër ne mund t'ia paraqesim librin
5 dëshmitarit, po ky libër nuk mund të paraqitet sipas
6 dispozitave të rregullës 143.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse po e kuptoj unë siç
8 duhet argumentin tuaj, ju thoni që ne duhet ta shohim këtë
9 libër në thelb si një deklaratë të dëshmitarit, këtë po thoni
10 ju?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Si e kuptojmë ne, libri,
12 intervistat në gazetë, në televizion mund t'i paraqiten
13 dëshmitarit si një deklaratë e mëparshme jo konsistente.

14 Por nuk është rasti më qysh prej të premtës dhe na keni
15 vendosur në një rrugë tjetër procedurale tani. Unë po ju them
16 edhe një herë, pozicioni ynë është ky që aplikimi i këtij
17 përkufizimi duhet të jetë konsistent tashmë, nuk mund t'i
18 themi një dëshmitari që vjen për dëshmi *viva voce* kur kemi
19 rastin që një dëshmitar ka mospërputhje mes deklaratave që ka
20 dhënë edhe t'i japim një libër tani dhe t'i themi, hajde
21 nxjerr ti dëshmi ky nga libri nuk është normale. Kjo është e
22 pikë e parë.

23 Dhe pika e dytë nuk është intervistë që është marrë në
24 kontekst të procesit gjyqësor. E rrjedhimisht nuk përputhet me
25 përkufizimin sipas rregullës 143(2)(c). Dhe nuk mund të marrim

1 një deklaratë të një dëshmitari që është thirrur nga
2 Prokuroria, nga pala dhe t'i japim ne të drejtën e atyre, të
3 mbështetur në një deklaratë që ka bërë ai në një libër që
4 është në kundërshtim me deklaratën *viva voce* për të njëjtin
5 aspekt.

6 Unë nuk po them që Prokuroria duhet patjetër të
7 mbështetet në atë që thotë ai *viva voce*, ama nuk duhet të
8 mbështetet në diçka që është e ndryshme nga ajo që ky person
9 thotë në sallën e gjyqit. Sepse nuk është një dokument i kohës
10 kur kanë ndodhur ngjarjet.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mbështes parashtrimin e z.
12 Misetic, por në të njëjtën kohë dua t'ju rikujtoj edhe një
13 herë përmbajtjen e intervistës që ka dhënë dëshmitari për ZPS-
14 në, që postura e dëshmitarit përgjatë gjithë intervistës,
15 qëndrimi, më falni, i dëshmitarit gjatë gjithë inter -- i
16 dëshmitarit, ka qenë që libri në të vërtetë ka shtrembërime të
17 konsiderueshme të cilat i ka përdorur për të promovuar
18 karrierën politike të autorit.

19 Nuk dua të hyj shumë në historikun e dëshmisë së
20 dëshmitarit 4325, por është disi ndryshe nga pikëpamja
21 procedurale se ne e dimë pa filluar që libri është plot me
22 gjëra që dëshmitari thotë janë të pavërteta dhe do jemi në një
23 pozicion apo do e vendosim veten në rrezik kur do pranojmë
24 pjesë të caktuara të deklaratës.

25 Tani ajo që nuk ndodhi në rastin e 4325-s është të

1 kuptojmë çfarë është e vërtetë dhe çfarë nuk është e vërtetë;
2 cilat pjesë i pohonte; cilat pjesë i mohon.

3 Ky është një skenar i rrezikshëm për ne që të pranoni ju
4 deklaratë të një dëshmitari ku vetë dëshmitari thotë që ka
5 pjesë të caktuara që nuk janë të vërteta, përveç nëse keni ju
6 ndonjë procedurë që ta shqyrtoni paragraf më paragraf
7 deklaratën për të zbuluar cila pjesë është e vërtetë dhe cila
8 pjesë nuk është e vërtetë.

9 Ka ndodhur kjo me dëshmitarin e mëparshëm. Kjo është
10 situata ndryshe, sepse libri nuk po paraqitet për vërtetësinë
11 e përmbajtjes, por do përdoret për të nxjerrë dëshmi nga
12 dëshmitari. Por, në thelb, pasoja është njësoj.

13 Edhe pse kemi situata të ndryshme këta janë dëshmitarë që
14 i kanë thënë ZPS-së edhe përmes ZPS-së dhe Trupit Gjykses se
15 dokumentet janë të mbushura me gjëra të pavërteta. Nuk është
16 normale të përdoret një dokument për vërtetësinë e përmbajtjes
17 në asnjë mënyrë të mundshme. Në rast, nëse nuk e marrim rresht
18 për rresht atë që ka thënë ky dëshmitar.

19 Ky është shqetësimi im për procedurën dhe buron nga
20 dëshmitari i fundit. Të paktën me këtë dëshmitar dallimi do
21 jetë që t'i dëgjojmë përgjigjet, pastaj nëse do shohim nëse do
22 pranohet i gjithë libri për vërtetësinë e përmbajtjes siç e
23 bëtë me dëshmitarin e radhës.

24 Por edhe një herë po ju themi që dëshmia është e mbushur
25 me elemente të pavërtetë. E vetmja mënyrë si mund të përdoret

1 ky dokument nga Trupi Gjykses është Trupi Gjykses ta këtë
2 shqyrtuar paragraf për paragraf.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju po thoni
4 që shumë nga gjërat që ka thënë ai në libër s'janë të vërteta.
5 Kjo s'është vërtetuar. Ai s'e ka thënë diku. Ai po thotë tani
6 që s'janë të vërteta.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po është skenar tjetër, se
8 dëshmitari i parë erdhi dhe na e tha disa janë të vërteta
9 s'janë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund ju
11 po thoni që po erdhi dëshmitari këtu dhe thotë që të gjitha
12 gjërat që kam thënë s'janë të vërteta ne t'i japim fund
13 dëshmisë?

